



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 22 (JR)  
Datë 19.10.2018

Nr. 10 i vendimit  
Datë 18.04.2019

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Relator</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Luan Daci</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 18.04.2019, ditën e enjte, ora 11:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Admir Thanza, gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 40, datë 17.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, Dh, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në

Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes, analizoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 40, datë 17.07.2018, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Admir Thanza, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë.*

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), pasi ka filluar *ex officio* procesin e rivlerësimit, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, ka zhvilluar seancën dëgjimore publike dhe, pasi ka marrë në shqyrtim të gjitha provat e administruara, si dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimet e mëposhtme.

a) Sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë:

- o Nuk është deklaruar çmimi i pasqyruar në kontratën e shitblerjes për apartamentin në rr. {\*\*\*}, Shkodër, prej 1.200.000 lekësh, por ai është deklaruar nga subjekti në vlerën prej 3.000.000 lekësh.
- o Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, të dorëzuar më datë 17.03.2004, mungon deklarimi i garazhit të blerë në rr. {\*\*\*}, Shkodër.
- o Çmimi i pasqyruar në kontratë (prej 1.200.000 lekësh), për apartamentin në rr. {\*\*\*}, Shkodër, rezulton të jetë shumë më i vogël, në krahasim me çmimin mesatar të tregut.
- o Modifikimi i bërë në njërin nga formularët “A1”, në faqen nr. 4, nuk është bërë në përputhje me procedurat dhe udhëzimet e institucionit përkatës, pasi mungon një procesverbal që ta pasqyrojë këtë veprim ndërhyrjeje në një dosje të administruar.
- o Shuma e cituar për rregullimet/punimet e pretenduara nuk rezulton të jetë e provuar me dokumentacion relativ.
- o Të ardhurat nga shitja e kryer më datë 16.11.2000 – të deklaruara nga subjekti si burim financiar për blerjen e apartamentit në rr. {\*\*\*}, Shkodër – nuk mund të përdreshin për pagesën e blerjes së tij, të realizuar më datë 06.04.2000, pasi shitja është kryer në nëntor të vitit 2000.
- o Çmimi i apartamentit në rr. {\*\*\*}, Tiranë, prej 113 m<sup>2</sup>, i deklaruar në vlerën prej 4.000.000 lekësh, në deklaratën e vitit 2003, nuk përputhet me atë të pasqyruar në kontratën e shitblerjes, që ka rezultuar se ishte 1.950.000 lekë.
- o Garazhi në rr. {\*\*\*} nuk ka qenë i deklaruar as kur është blerë, në deklaratën e vitit 2007, as në deklaratat e viteve të mëpasshme, 2008-2016, periudhë gjatë së cilës kjo pronë është poseduar.
- o Mungesë burimesh financiare të ligjshme në periudhën 1992-2003, në shumën prej 2.727.865 lekësh, si dhe përgjatë periudhës 2004-2016, gjatë së cilës rezultojnë me bilanc negativ 4 vite, përkatësisht 2004, 2005, 2008, 2009, përgjatë të cilave rezulton një mungesë burimesh financiare të ligjshme, në shumën prej 4.427.471 lekësh.
- o Nga analiza financiare për periudhën 1992-2016, rezulton se të ardhurat e ligjshme të realizuara nga subjekti i rivlerësimit nuk kanë qenë të mjaftueshme për të përballuar blerjet e pasurive të paluajtshme, kursimet, pra gjendjen e likuiditeteve në bankë dhe *cash*-in në shtëpi, si dhe për të kryer shpenzimet jetike dhe ato të deklaruara.

Në përfundim, sa i përket kriterit të pasurisë:

*Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe nuk ka dhënë shpjegime bindëse, referuar pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si dhe parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës.*

b) Sa i përket kriterit të vlerësimit të figurës, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të pasaktë dhe të pavërtetë. Subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe mund të vihet nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, nenit 38 dhe pikës 2 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, në bazë të konkluzionit të organeve ligjzbatuese, rezulton i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës dhe nuk ka dhënë shpjegime apo prova bindëse për të kundërtën.

c) Sa i përket kriterit të vlerësimit profesional, rezulton se, pavarësisht vlerësimit pozitiv të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, subjekti i rivlerësimit, në saje të problemeve me etikën – të mosdorëheqjes së tij nga gjykimi i një çështjeje ku njëra nga palët ishte formalisht dhuruese ndaj tij; të konstatimit të papërshtatshmërisë së tij me detyrën e gjyqtarit, të deklarameve të pavërteta, të pamjaftueshme dhe fiktive – bazuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë.

2. Kundër vendimit nr. 40, datë 17.07.2018, të Komisionit, brenda afatit ligjor, rezulton të jetë ushtruar ankim nga subjekti i rivlerësimit Admir Thanza (në vijim subjekti). Ankimi rezultoi i plotë, me elemente procedurale, si të formës, edhe të përmbajtjes. Për rrjedhojë, Komisioni, me vendimin e tij nr. {\*\*\*}, datë 05.10.2018, ka vendosur pranimin e ankimit të datës 03.10.2018, me nr. {\*\*\*}prot., të paraqitur nga subjekti, si ankim i plotë dhe në përputhje me nenin 46 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim ligji nr. 49/2012).

## **II. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit**

Subjekti i rivlerësimit Admir Thanza, në ankimin e tij ndaj vendimit nr. 40, datë 17.07.2018, të Komisionit, ka paraqitur shkaqet ankimore të mëposhtme.

3. Komisioni nuk bazohet në fakte dhe rrethana të vërteta kur e shtyn seancën dëgjimore për shkak se subjekti i rivlerësimit kërkon më shumë kohë në dispozicion për të përgatitur mbrojtjen e tij, ndërkohë që kur i ka dërguar njoftimin për seancën e re, në *e-mail* Komisioni ka bashkëlidhur edhe metodikën e përdorur në kryerjen e analizës ekonomike, të modifikuar në saje të dokumentacionit dhe të shpjegimeve të marra nga ana e subjektit. Si rrjedhojë, Komisioni nuk e ka shtyrë seancën për të përgatitur mbrojtjen subjekti, por për të realizuar vetë Komisioni një analizë ekonomike të re, të emërtuar “e modifikuar”.
4. Detyrimi kushtetues për të plotësuar një deklaratë të re të detajuar të pasurisë (deklarata *vetting*) është dokumenti ligjor nga i cili do të fillojnë të evidentohen përgjegjësitë e subjekteve të rivlerësimit për shkelje disiplinore, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose përdorim, pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ndaj Komisioni ka juridiksion kushtetues dhe ligjor që të vlerësojë pasurinë duke u mbështetur vetëm në kontrollin e deklarames *vetting* dhe deklaramet periodike të pasurisë mund të përdoren si provë (neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016) dhe jo të jenë veçmas objekt kontrolli, por vetëm në funksion të krahasimit të të dhënave me deklaramen *vetting*.
5. Subjekti pretendon se Komisioni në vendimin e tij analizon marrëdhënien juridike konsensuale mes individit dhe shoqërisë ndërtuese, ndërkohë që kontrata e shitjes është akt autentik ligjor, për sa i përket vullnetit, qëllimit dhe mënyrës së lidhjes së saj, sepse ka fuqinë e ligjit për palët që e kanë nënshkruar atë (neni 690 i Kodit Civil).

6. Pjesën më të madhe të vlerësimit të pasurisë në Komision, e zë analizimi i dy pasurive, njëra me sipërfaqe 136 m<sup>2</sup> në Shkodër dhe tjetra me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup> në Tiranë, të cilat nuk janë më në pronësinë e subjektit, pasi janë shitur. Në këtë kuptim, subjekti pretendon që këto pasuri duhet të analizoheshin nga Komisioni në kuadrin e burimit të ligjshëm që ka krijuar pasurinë.
7. Analiza e pasurisë në Komision është rezultat i një gjykimi të njëanshëm, duke u mbështetur vetëm në provat që Komisioni ka mbledhur, pa analizuar dhe shqyrtuar fare provat e subjektit të rivlerësimit, gjë e cila cenon parimin e procesit të rregullt gjyqësor, të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.
8. Subjekti pretendon se nga vendimi i Komisionit nuk rezulton në asnjë pikë të tij të ketë konstatuar kundërshti apo mospërputhje deklarimesh ndërmjet deklaratës *vetting* dhe atyre periodike të pasurisë.
9. Juridiksioni dhe kompetenca me të cilat Kushtetuta dhe ligji e kanë ngarkuar Komisionin për të ushtruar procesin e rivlerësimit, nuk mund të kufizohen dhe të jenë vetëm gjetje të gabimeve ndër vite të subjekteve që rivlerësohen. Madje duhet që Komisioni këto pasaktësi t'i identifikojë nëse janë pikërisht ato mjete me të cilat subjekti i rivlerësimit fsheh pasurinë apo burimin e krijimit të saj.
10. Referuar nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile – “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre, për fakte që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre.” – subjekti pretendon se formulari A1, f. 4, përbën provë të plotë dhe të pakontestueshme.
11. Lidhur me vlerësimin e pasurisë, vendimi i Komisionit është i njëanshëm, i mbështetur vetëm në provat që ai vetë ka mbledhur, pa shqyrtuar dhe analizuar provat dhe pretendimet e tij. Kjo sjell cenim të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe, konkretisht, të parimit të aksesit, të arsyesimit të vendimit gjyqësor, të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.
12. Konkluzionet që ka arritur Komisioni në vendim bien ndesh me parimin e procesit të rregullt ligjor, duke cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë. Kështu subjekti i është referuar jurisprudencës së GjEDNj-së, duke përmendur këtu çështjen e *Allenet de Ribemont kundër Francës*, *Rushiti kundër Austrisë*, *Paraponiaris kundër Greqisë*, vendimet e të cilave konkludojnë se shprehja e çdo dyshimi të fajit është e papajtueshme me prezumimin e pafajësisë.
13. Lidhur me pasurinë nr. 1, apartament banimi 3 + 1, me sipërfaqe 136 m<sup>2</sup>, në rr. “{\*\*\*}”, Shkodër, fituar me kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep. dhe {\*\*\*} kol., datë 06.04.2000, regjistruar në ZRPP Shkodër, më date 18.05.2000, subjekti ka paraqitur në ankim pretendimet si vijojnë:
  - 13.1 Subjekti pretendon për këtë pasuri se vlera e blerjes së apartamentit, 1.200.000 lekë, duke shtuar edhe vlerën e rikonstruksionit, 1.800.000 lekë, është vlera reale e investimit për këtë apartament. Për të qenë më i saktë, përveç vlerës së blerjes së apartamentit, ka deklaruar vullnetarisht edhe shpenzimet. Pra sipas tij, ka bërë një deklaram të plotë dhe real të vlerës së apartamentit, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim ligji nr. 9049) në deklaramin e parë në vitin 2003. Do të përbënte shkelje, pretendon subjekti, sikur të kishte deklaruar vetëm çmimin e blerjes së apartamentit, pa shpenzimet e tjera që janë bërë për rregullime me të ardhura të ligjshme.

**13.2** Subjekti pretendon se në kundërshtim me detyrimet kushtetuese dhe ligjore, Komisioni nuk bën fare analizë nëse kjo pasuri është e justifikuar me të ardhurat e ligjshme të tij dhe të personave të lidhur.

**13.3** Konstatimi i Komisionit se çmimi i pasqyruar në kontratë (1.200.000 lekë) është shumë më i vogël në krahasim me çmimin mesatar të tregut, nuk është i bazuar në ligj dhe në prova. Për këtë duhet t'i ishte referuar VKM-së nr. 362, datë 14.07.2000, "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe koeficientit "K". Kjo VKM përcakton se çmimi mesatar i koston së ndërtimit në tregun e lirë, në qytetin e Shkodrës, për vitin 2000, është 25.825 (njëzet e pesë mijë e tetëqind e njëzet e pesë) lekë për m<sup>2</sup>. Duke e shumëzuar këtë kosto me metrat katrorë të deklaruar, rezulton që çmimi mesatar i tregut të lirë për qytetin e Shkodrës, për këtë sipërfaqe, në vitin 2000, ka qenë 3.512.200 lekë, pak a shumë i përafërt me koston e apartamentit të banimit të deklaruar nga subjekti.

**13.4.** Subjekti ankimon edhe konstatimin tjetër të Komisionit se: "Çmimi i deklaruar 3.000.000 (tre milionë) lekë për blerjen e apartamentit dhe garazhit rezulton të ketë qenë sa gjysma e çmimit të tregut në atë vit", pasi rezulton, sipas subjektit, që ky është një konstatim sa i gabuar ligjërisht, aq edhe në prova. Sipas tij, këto konstatime janë të njëanshme, subjektive dhe kanë për qëllim për ta rënduar padrejtësisht, duke pasqyruar në mënyrë të deformuar realitetin.

**13.5** Në referencë edhe të standardit tashmë të vendosur prej Komisionit në raste të ngjashme, Komisioni (bazuar në nenin 50 të ligjit nr. 84/2016) duhet të kishte kërkuar informacion në ZVRPP Shkodër, në lidhje me çmimin e transaksioneve të pronave të tjera kufitare, dhe vetëm pas krahasimit të këtyre kontratave të arrinte në konkluzionin e saktë se sa ka qenë çmimi mesatar i tregut në atë periudhë në qytetin e Shkodrës. Për periudhën e lidhjes së kësaj kontrate, nuk ka pasur përcaktime ligjore lidhur me çmimin e detyrueshëm të referencës.

**13.6.** Subjekti ankimon dy konkluzione të Komisionit – a) Në deklaratën e vitit 2003 mungon deklarimi i garazhit. b) Modifikimi në njërin nga formularët "A1", në faqen 4, nuk është bërë në përputhje me procedurat dhe udhëzimet e institucionit përkatës, pasi mungon një procesverbal që të pasqyrojë këtë ndërhyrje në një dosje të administruar. – të cilat i kundërshton së bashku për vetë relevancën që ato kanë. Subjekti ankimon faktin se Komisioni analizon veçmas deklaratën e vitit 2003, pa e krahasuar atë me deklaratën *vetting*, dhe faktin që Komisioni në kundërshtim me ligjin nr. 9049/2003 e ngarkon me përgjegjësinë e mungesës së një procesverbali, i cili duhet të ishte plotësuar dhe administruar në dosjen e subjektit, nga ILDKPKI-ja. Detyrimin ligjor për të verifikuar rregullsinë e plotësimit të deklaratës e kishte ILDKPKI-ja, që duhet të kryente edhe përpunimin paraprak të saj (sipas nenit 24 të ligjit nr. 9049) dhe, sipas rastit, të bënte edhe plotësime për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.

**13.7.** Në lidhje me vërtetësinë e formularit A-1 të vitit 2003, subjekti pretendon se atë e konfirmon edhe vetë ILDKPKI-ja, e cila në raportin përfundimtar të kontrollit të pasurisë e vlerëson të mirëqenë dhe të saktë deklarin e garazhit që në vitin 2003, dhe njëkohësisht edhe vlefshmërinë e këtij formulari. Ky qëndrim, pretendon subjekti, bie ndesh edhe me interpretimet kushtetuese të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, e cila ka theksuar se gabimet për mosplotësimin e detyrimeve ligjore të punonjësve të administratës nuk mund t'i ngarkojnë me përgjegjësi dhe as t'i cenojnë ata në të drejtat e tyre (këtu referon edhe vendimin nr. 32, datë 22.07.2011, të Gjykatës Kushtetuese).

**13.8.** Lidhur me rezultatin e Komisionit se të ardhurat nga shitja, të realizuara në nëntor 2000, nuk mund të përdoren për blerjen e apartamentit të realizuar në prill të vitit 2000, subjekti pretendon se Komisioni nuk e ka marrë parasysh deklarin e burimit në

deklaratën *vetting*, ku është deklaruar se për krijimin e këtij apartamenti, me sipërfaqe 136 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Shkodër, kanë shërbyer të ardhurat nga paga ime, *aktiviteti privat i b/shortes sime dhe nga shitja e apartamenteve*. Që këtej, subjekti shpjegon se çmimi i blerjes së apartamentit dhe garazhit, prej 1.200.000 lekësh, i është likuiduar shoqërisë {\*\*\*} ShPK në datën e lidhjes së kontratës nga të ardhurat familjare, ndërsa pjesa tjetër me shitjen e dy apartamenteve në nëntor 2000, duke mbuluar shpenzimet e punimeve.

**13.9.** Konstatimin e Komisionit (f. 8, pika d) “se një pjesë e shpenzimeve prej 800.000 lekësh është e pajustificuar me burime të ligjshme”, subjekti e kundërshton duke pretenduar se për të vlerësuar nëse ka pasur të ardhura të ligjshme, Komisioni duhej t’i referohej analizës financiare për periudhën 1992-1999, gjatë së cilës ai ka pasur disponibilitet të ardhurash në vlerën 2.923.861 lekë, të siguruara nga puna e tij dhe e bashkëshortes (pa përfshirë të ardhurat nga shitja e apartamentit në vlerën 500.000 lekë).

- 14.** Lidhur me pasurinë nr. 2, subjekti pretendon se kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *vetting*, si një nga burimet për krijimin e pasurisë me sipërfaqe 149 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë, prandaj Komisioni kishte detyrimin e analizimit të saj vetëm në kuadrin e burimit të ligjshëm dhe jo të analizonte veçmas mënyrën e deklarimit të kësaj pasurie në deklaratën e vitit 2003.

**14.1.** Në vendim, Komisioni konstaton: “[...] Çmimi i apartamentit në rrugën “{\*\*\*}, me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup>, i deklaruar në vlerën 4.000.000 lekë, në deklaratën e vitit 2003, nuk përputhet me atë të pasqyruar në kontratën e shitblerjes, që ka rezultuar se ishte 1.950.000 lekë. [...]”.

Subjekti ankimon këtë rezultat të Komisionit dhe pretendon se ai në deklaratën e parë 2003 ka bërë një deklaram të plotë dhe real dhe, përveç çmimit të blerjes, ka deklaruar edhe shpenzimet për rregullimet ndërtimore, që si investim në total është 4.000.000 lekë. Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *vetting* si një nga burimet e krijimit të pasurisë apartament, me sipërfaqe 149 m<sup>2</sup> (aktualisht në pronësi të subjektit) dhe jo të analizohej veçmas për mënyrën e deklarimit të kësaj pasurie, në deklaratën e vitit 2003.

**14.2.** Subjekti ankimon se për këtë pasuri, hamendësimet, e ngritura nga Komisioni në vendim, nuk arrijnë nivel provueshmërie dhe se deklarimi vjetor i vitit 2003 duhej të vlerësohej si provë, duke u bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

- 15.** Lidhur me pasurinë nr. 3, garazh me sipërfaqe 23,4 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën {\*\*\*}, Tiranë, rezultojnë të deklaruar vetëm në deklaratën *vetting*, pasuri e blerë nga bashkëshortja e subjektit, me kontratën nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 18.01.2007, me çmimin 400.000 lekë, regjistruar në ZRPP Tiranë, më datë 12.02.2007.

Subjekti e ka pranuar në përgjigjet e tij se mosdeklarimi i garazhit në deklaratën periodike të vitit 2007 është vetëm një harresë dhe gabim material i kryer pa dashje, por kursesi fshehje. Ky gabim është korrigjuar në deklaratën *vetting*, e cila duhej të ishte objekt i kontrollit nga Komisioni. Komisioni ka vlerësuar se mosdeklarimi në lidhje me pasurinë garazh përbën veprime dhe qëndrime të subjektit që rezultojnë në mosrespektim të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, si dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, dhe si të tilla çojnë në aplikimin e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

- 16.** Për sa u përket likuiditeteve, subjekti ka ankimuar analizën financiare të Komisionit dhe ka deklaruar se ka të ardhura të ligjshme për të përballuar shpenzimet e kryera dhe për të mundësuar kursimet e deklaruara në deklaratat periodike.

- 17.** Lidhur me konkluzionet e trupit gjykues të Komisionit për kontrollin e kriterit të figurës, subjekti ka parashtruar në ankim shkaqet si vijojnë:

17.1 Subjekti lidhur me mosdeklarimin e faktit të pushimit të procedimit penal nr. 3 të vitit 2016, pretendon se nuk e ka deklaruar për arsye se faktet që janë provuar nga hetimi, nuk përmbushin elementet e veprës penale, të parashikuara nga nenet 244 dhe 259 të Kodit Penal dhe as të ndonjë vepre penale tjetër, bazuar në nenin 328, pika 1, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale. Organi i Prokurorisë ka pushuar hetimin e procedimit penal, pasi ka konstatuar se nuk ka përfshirje të tijën dhe as të shtetas L.H. në asnjë vepër penale.

17.2 Në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale të kohës, veprat penale të parashikuara nga nenet 244 dhe 259 të Kodit Penal, për të cilat është filluar procedimi penal, nuk përfshiheshin në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 35/2017, datë 30.03.2017, këto dy vepra penale janë shtuar në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Duke qenë se ligji nr. 84/2016 ka hyrë në fuqi më datë 08.10.2016 dhe procedimi penal është pushuar më 29.07.2016, është evidente që këto vepra nuk përshihen nga ligji i kohës, neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, duke shkelur kështu parimin e përgjithshëm se ligji nuk ka fuqi prapavepruese.

17.3 Subjekti sqaron se neni 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, në pjesën e parë të tij ka dhënë një kuptim të përgjithshëm lidhur me personin e përfshirë në krimin e organizuar, kur ai rezulton i dënuar ose i proceduar penalisht, duke përjashtuar rastin kur personi është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ndërsa në pjesën e dytë, gjerat “a” dhe “b” japin një parashikim më të specifikuar të përfshirjes së personit në krimin e organizuar, ku germa “a” përkon me germën “ç”, pika 1 e nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, kurse germa “b” përkon me germën “ç”, pika 1 e nenit 388 Kodit të Procedurës Penale. Ndaj subjekti pretendon se për të gjitha rastet e tjera të pushimit të procedimit penal, të përmendura në nenin 328 të Kodit të Procedurës Penale, personi nuk do të konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar.

17.4 Subjekti ngre si shkak ankimor se neni 38, pika 4, germa “d” e ligjit nr. 84/2016, parashikon: “Subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, publikuar ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës”. Sipas vendimit të pushimit të procedimit penal, subjekti është takuar me shtetasen L.H., më 31.01.2016 dhe më 04.02.2016, ndërsa çështja penale ndaj saj është regjistruar më datë 08.04.2016, që këtej rrjedh se në momentin e takimit nuk ka qenë proceduar penalisht dhe, për pasojë, takimi i tij me të, në këtë periudhë, nuk mund të konsiderohet si kontakt i papërshtatshëm.

17.5 Subjekti pretendon se në pikat 8 dhe 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë parashikime të ndryshme lidhur me krimin e organizuar. Në pikën 8 jepet kuptimi i lidhjes së personit me veprën penale, kurse në pikën 15 përcaktohet lidhja e pasurisë me veprën penale. Kështu ndaj shtetas L.H. nuk është marrë ndonjë masë pasurore, sipas ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, ndaj ky fakt provon se shtetasja nuk ka qenë asnjëherë subjekt i këtij ligji, pra nuk mund të konsiderohet si person i përfshirë në krimin e organizuar.

17.6 Duke iu referuar edhe vendimit të Gjykatës së Lartë (jounifikues) nr. 126, datë 22.06.2016, paragrafi 23, citohet se *vendimi i pushimit të prokurorisë duhet të barazohet me vendim pafajësie të formës së prerë, për shkak se ai nuk rezulton të jetë ankimuar [...]*. Si rrjedhojë, duke analizuar vendimin nr. 3 të vitit 2016 të Prokurorisë së Përgjithshme, duke qenë se është vendim i formës së prerë, barazohet me vendimin e pafajësisë së formës së prerë.

17.7 Subjekti i rivlerësimit ankimon pikën 2 të raportit të DSIK-së, sipas së cilës: “[...] Për subjektin e rivlerësimit Admir S. Thanza administrohen informacione nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e tij apo për kontakte të papërshtatshme.

Subjekti pretendon se nëse do të kishte prova të tjera, veç atyre të procedimit penal nr. 3, këto prova nuk i janë vënë në dispozicion nga Komisioni, i cili kishte detyrimin kushtetues e ligjor t'ia vinte në dispozicion dhe t'i jepte mundësinë për t'i kundërshtuar dhe të drejtën e mbrojtjes. Sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, *askush nuk mund të gjykohet dhe dënohet mbi bazën e provave për të cilat individi nuk ka mundësi të mbrohet.*

18. *Lidhur me konkluzionet e Komisionit për vlerësimin e kriterit profesional, subjekti ka parashtruar në ankim shkaqet si vijojnë:*

18.1 Në lidhje me aftësitë organizative, si konstatimi i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë që, sipas subjektit, është i pambështetur në ligj, trupit gjykues, pasi këqyri dokumentacionin në fashikull, i rezultuan probleme që lidhen me relacionet e këshilltarëve të subjektit. Neni 20 i ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, parashikonte se gjyqtari kishte deri në dy ndihmës ligjorë, dhe neni 21 i këtij ligji parashikonte se ndihmësit ligjorë studionin ankimet, dosjet gjyqësore, përgatisnin relacionet për çështjet që ishin në gjykim duke dhënë mendimin e tyre, u përgjigjeshin ankesave, përgatisnin materialet e nevojshme etj. Pra, subjekti pretendon se është detyrë e ndihmësve ligjorë përgatitja e relacionit dhe plotësimi i tij me elementet e domosdoshme procedurale, prandaj mangësi të kësaj natyre nuk lidhen me çështje të aftësive organizative të një gjyqtari të Gjykatës së Lartë.

18.2 Gjithashtu subjekti pretendon se lidhur me mangësitë e konstatuara me procesverbalet në dhomë këshillimi, në Gjykatën e Lartë, në çështjet civile nga Kolegji Civil, nuk mbahet procesverbal. Në këto raste, nuk jemi para parashikimeve të nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile, siç është përmendur në raport. Në shqyrtimin në dhomë këshillimi të çështjeve civile, nuk merr pjesë sekretari gjyqësor.

19. *Lidhur me konkluzionet e trupit gjykues të Komisionit për etikën dhe integritetin, subjekti ka parashtruar në ankim shkaqet si vijojnë:*

19.1 Për sa i përket kontratës së dhurimit, kjo e fundit është realizuar vetëm për formalizimin e regjistrimit në ZRPP Shkodër, ndaj nuk përbën një dhurim të mirëfilltë. Për më tepër, ky dhurim nuk ka cenuar pavarësinë apo paanshmërinë gjatë një procesi gjyqësor, thekson subjekti. Kjo kontratë dhurimi u realizua për arsye se ZVRPP Shkodër, tërësisht në shkelje të kontratës së vitit 2000 dhe detyrimeve ligjore, e ka regjistruar këtë garazh në vitin 2013 edhe një herë në emër të shoqërisë ndërtuese {\*\*\*} ShPK.

19.2 Subjekti pretendon se nuk gjendet para konfliktit të mundshëm të interesit, për sa u përket çështjeve në Gjykatën e Lartë të shoqërisë ndërtimore {\*\*\*} ShPK. Konflikti i interesit nuk mund të ndodhte, sepse interesi i supozuar nuk ka ekzistuar as në momentin e lidhjes së kontratës së dhurimit, pasi çështja në Gjykatën e Lartë ku subjekti ka qenë relator, nuk lidhet fare me zgjidhjen e konfliktit të themelit ndërmjet palëve ndërgjyqëse, pasi ishte një konflikt ndërmjet gjykatave lidhur me çështje të kompetencës lëndore.

20. *Lidhur me konkluzionet e trupit gjykues të Komisionit për precedentin penal në Itali, në vitin 1999, subjekti ka parashtruar në ankim shkaqet si vijojnë:*

20.1. Subjekti pretendon se Komisioni mund të hetonte dhe të vlerësonte të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret, por për asnjë arsye nuk duhej të bënte interpretimin për mënyrën e plotësimit në formularin e vetëdeklarimit. Vlerësimi i të dhënave të pasqyruara në këtë formular i referohet vetëm ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

20.2 Subjekti pretendon se Komisioni ka bërë shkelje të rëndë, lidhur me publikimin e kësaj të dhëne personale sensitive, publikimi i së cilës në seancë dëgjimore ka shkaktuar



mediatizimin e tyre, duke e cenuar në mënyrë flagrante dhe duke shkelur kështu nenin 3, pika 2, si dhe nenet 5,6,7,8 dhe 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

### III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për procedurën

21. Juridiksioni i Rivlerësimit dhe kompetenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit përcaktohen në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon: “Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese [...]”, si dhe në nenin 5, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave: “1. Procesi i vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, komisionerët publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë. 2. Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Komisionit dhe ka mandat 9-vjeçar”.
22. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim Kolegji) zhvillohet bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48/1, 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim ligji nr. 49/2012).
23. Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit fillimisht konstatoi se subjekti i rivlerësimit Admir Thanza legjitimohet për të ushtruar ankim në Kolegj, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës (*ratione personae*) dhe se, në kuptim të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ankimi i tij është depozituar brenda afatit ligjor (*ratione temporis*). Sipas dëftesës së postës, rezulton se më datë 19.09.2018, i është dorëzuar vetë subjektit vendimi nr. 40 i Komisionit. Më datë 03.10.2018, subjekti ka paraqitur ankimin brenda 15 ditëve, që është afati ligjor për të ushtruar ankim.
24. Në Kolegj janë paraqitur denoncimet, më datë 07.12.2018 nga shtetasi Sh.B. dhe më datë 02.04.2019 nga shtetasit B.I. dhe P.I. Trupi gjykues, pasi vlerësoi këto denoncime sipas kërkesave të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, vendosi për mosfillimin e hetimit për praktikat e denoncimeve të këtyre shtetasve, pasi shkeljet e pretenduara nuk përmbanin shkaqe të mjaftueshme për t’u hetuar.
25. Subjekti, më datë 12.04.2019, ka paraqitur në Kolegj parashtrimet e tij me shkrim, pas njoftimit për gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi më datë 18.04.2019. Ne respektim të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, procesi gjyqësor në Kolegj u krye në përputhje me rregullat e parashikuara nga nenet 47, 48, pika 1, 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012. Shqyrtimi i ankimit të subjektit u zhvillua në dhomë këshillimi në bazë dokumentesh.
26. Duke qenë se në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë në Republikën e Shqipërisë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* me përparësi.
27. Më datë 30.11.2017, me vendimin nr. 1, Komisioni ka vendosur të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm<sup>1</sup> për subjektin Admir Thanza.
28. Më datë 08.05.2018, Komisioni ka vendosur të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Admir Thanza, për të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016. Këto rezultate iu njoftuan edhe subjektit më datë 28.05.2018, duke i njoftuar njëkohësisht edhe kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, të drejtën me njohjen e provave të administruara, sipas nenit 47 të ligjit nr.

<sup>1</sup> Neni 45 i ligjit nr. 84/2016.

84/2016, si dhe përbërjen e trupit gjykues, me ftesën që duhej të deklaronte nëse kishte konflikt interesi me ndonjërin nga anëtarët e trupit gjykues. Më datë 22.06.2018, subjekti i rivlerësimit, pasi i ka kërkuar Komisionit kohë shtesë dhe kjo kohë i është dhënë, ka dërguar shpjegimet dhe dokumentacionin mbështetës mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

29. Janë zhvilluar dy seanca dëgjimore, saktësisht më 10.07.2018 dhe më datë 17.07.2018, në prezencë të subjektit të rivlerësimit dhe të përfaqësuesit të tij ligjor, i cili në këtë seancë parashtrroi shpjegimet përkatëse për rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.
30. Inspektorati i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), nëpërmjet raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar, ka bërë analizimin e të dhënave të deklaruara nga subjekti me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, nga i cili ka rezultuar se për subjektin Admir Thanza:
  - a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
  - b) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
  - c) ka kryer fshehje të pasurisë;
  - ç) ka kryer deklarim të rremë;
  - d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
31. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, duke dërguar me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017, raportin për kontrollin e figurës, sipas të cilit rezultoi se:
  1. Subjekti i rivlerësimit Admir Thanza ka plotësuar saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, të firmosur më datë 25.01.2017.
  2. Subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato që janë deklaruar në deklaratën e sipërpërmendur.
  3. Subjekti nuk ka deklaruar me vërtetësi, pasi nuk ka deklaruar procedimin penal në ngarkim të tij, për veprën penale të parashikuar nga nenet 244 dhe 259 të Kodit Penal. Kjo çështje rezultoi të jetë pushuar më datë 29.07.2016.
  4. Ekzistojnë të dhëna se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme.
  5. Ka gjithashtu pasaktësi në plotësimin e deklaratës për kontrollin e figurës, pasi subjekti nuk ka deklaruar kontaktet e papërshtatshme që ka pasur me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Ky mosdeklarim e ngarkon subjektin me përgjegjësinë e fshehjes së një fakti dhe të plotësimit të pasaktë dhe të pavërtetë të deklaratës për kontrollin e figurës.

Në këtë raport, DSIK-ja ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Admir Thanza.
32. Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale dhe ka përcjellë në Komision një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. {\*\*\*} prot., datë 17.11.2017. Në këtë raport, lidhur me “aftësitë organizative”, KLD-ja shprehet se subjekti ka pasur mangësi në aftësinë për të administruar dosjet, pasi ka pasur mungesë të relacionit të relatorit, kurse relacionet e këshilltarëve nuk kishin datë dhe firmë. Gjithsesi, KLD-ja edhe pse kishte konstatuar mangësi në aftësinë e administrimit të dosjeve, duke qenë pozitive të gjitha vlerësimet e tjera, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit është i aftë për vazhdimin e detyrës.
33. Komisioni me vendimin nr. 40, datë 17.07.2018, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit, si dhe pasi i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet dhe

provat e parashtruara nga subjekti, ka arritur në përfundimin që për subjektin e rivlerësimit Admir Thanza, gjyqtar në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë, të jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

34. Nëpërmjet ankimit të tij në Kolegj, subjekti i rivlerësimit Admir Thanza, kërkon rrëzimin e konkluzioneve të Komisionit, ndryshimin e vendimit nr. 40, datë 17.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas nenit 66, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe konfirmimin në detyrë sipas nenit 59, pika 1, gjerat “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, duke parashtruar në ankimin e paraqitur shkaqet, mbi të cilat i mbështet pretendimet e tij.

**Lidhur me pretendimet dhe shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit për shkelje të procesit të rregullt ligjor në Komision**

35. Subjekti pretendon se procesi i zhvilluar nga Komisioni dhe vendimi i dhënë në përfundim të tij janë rezultat i një hetimi administrativ të njëanshëm, i realizuar në kundërshtim të plotë me normat procedurale dhe në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, norma të detyrueshme për t’u zbatuar nga Komisioni në gjykimin e kësaj çështjeje. Në vendimin e Komisionit janë cenuar: i) parimi i arsytimit të vendimit; ii) parimi i aksesit; iii) parimi i kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve; iv) parimi i prezumimit të pafajësisë; v) parimi i pavarësisë dhe paanësisë; vi) parimi i ligjshmërisë; vii) parimi se ligji nuk ka fuqi prapavepruese (*zbatimi i ligjit në hapësirë dhe në kohë*). Këto parime janë të detyrueshme të zbatohen nga cilido organ shtetëror që zhvillon një proces administrativ, aq më shumë nga Komisioni, për vetë juridiksionin e tij të jashtëzakonshëm *ad hoc* dhe me kompetenca të një natyre *sui generis* dhe *quasi gjykatë*.

35.1 Nga shqyrtimi i procedurave nga trupi gjykues, rezulton se Komisioni, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, vendimin objekt shqyrtimi e ka marrë mbi bazën e vlerësimit të tri kriterëve në funksion të nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një hetim administrativ në respektim të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe të të drejtave themelore të subjektit. Subjektit i është garantuar e drejta e njohjes me dosjen, e drejta për të paraqitur shpjegime dhe prova, e drejta e njoftimit për zhvillimin e seancës dëgjimore publike, si dhe e drejta e dëgjimit në këtë seancë. Gjatë zhvillimit të seancës publike në Komision, subjekti Admir Thanza ka ushtruar të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave në mbrojtje të pretendimeve të tij. Për rrjedhojë, procesi rivlerësimit i zhvilluar në Komision që i përket subjektit Admir Thanza rezulton të jetë bërë në përmbushje të garancive procedurale, ligjore dhe të drejtave të tij.

36. Konstatimet e Komisionit, sipas subjektit, janë të pambështetura në ligj dhe prova, madje janë rrjedhë e një interpretimi ligjor të gabuar, me qëllim rëndues, duke përdorur standarde të ndryshme në cenim të parimit kushtetues të barazisë para ligjit, në lidhje me garazhin e blerë në vitin 2007 dhe të deklaruar në vitin 2017. Subjekti referon vendimin nr. 51, datë 25.07.2018 (vendim i formës së prerë), në të cilin Komisioni vlerëson së mungon qëllimi për fshehje pasurie nga ana e subjektit dhe realisht nuk figuron të ketë fshehje pasurie prej tij.

36.1. Kolegji i shqyrtonte çështjet dhe vendos standardet bazuar në parimet e procesit të rregullt ligjor, parimin e kontradiktoritetit, parimin e ligjshmërisë, parimin e sigurisë juridike dhe parimin e barazisë para ligjit. Në bazë të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji i Posaçëm i Apelit, në arsyetimin e vendimit të tij, orienton Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme. Sa më sipër, nga ana e Kolegjit vendosen standardet në bazë të parimeve kushtetuese kur gjykohet çështja prej tij.

37. Sipas subjektit, në rastin e tij Komisioni ka mbajtur qëndrim të kundërt me vendimet e tjera vijuese për situata tërësisht të njëjta. Komisioni njeh si të ligjshme dhe i konsideron

të justifikuara punimet shtesë të kryera në pasuri të paluajtshme të sapoblerë pa dokumentacion justifikues, duke i vlerësuar ato vetëm në funksion të burimit të ligjshëm (*vendime të Komisionit nr. 46, 58, 63, 36, 56, 84, 105, 112, 49, 62, 71, 79*).

**37.1** Trupi gjykues, bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjin e posaçëm nr. 84/2016, vlerëson se, nëpërmjet ankimit, evidentohen zbatimi i parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe problematikat të vendimmarrjes në Komision, dhe se Kolegji ka të drejtë të korigjojë çdo gabim procedural të kryer nga Komisioni. Kolegji, si organi i vetëm gjyqësor në procesin e rivlerësimit, në funksion të shqyrtimit të ankimit, zgjidh çështjen në mënyrë përfundimtare.

Pra, e anasjella e asaj që pretendon subjekti do të ishte problem, që një standard i vendosur më parë nga Kolegji, nëpërmjet arsytimit të një vendimi në të cilin ka korigjuar shkeljet procedurale dhe ka orientuar Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme, Komisioni nuk e ka zbatuar, duke përbërë shkak për cenimin e vendimit të tij.

- 38.** Në lidhje me vlerësimin e integritetit nga Komisioni, subjekti ankimon shkeljen që sipas tij ka kryer Komisioni lidhur me zbatimin e nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, sa i përket një ngjarjeje të ndodhur afërsisht 19 vite më parë, jashtë afatit kushtetues, duke u aplikuar në kundërshtim me ligjin, konkretisht pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti shprehet se ky vendim është marrë në mënyrë subjektive, të njëanshme, qëllimisht rënduese dhe diskriminuese, rrjedhojë e një interpretimi dhe zbatimi të gabuar të dispozitave specifike kushtetuese dhe ligjore duke afektuar në thelb vendimmarrjen e Komisionit dhe duke prodhuar dhënien e një vendimi të padrejtë, për sa i përket shkarkimit të tij.

**38.1** Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në nivele të larta të sistemit të drejtësisë, përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese. Vendimi i dënimit penal të formës së prerë ndaj tij, edhe pse përreth 19 vite më parë, kur subjekti kryente detyrën e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë besimin e publikut te drejtësia. Trupi gjykues i Kolegjit, në këtë vlerësim ka parasysh së pari se i gjithë kuadri ligjor që ka qenë në fuqi ndër vite në Republikën e Shqipërisë, në mënyrë konsistente e ka parashikuar si një ndër kushtet themelore për përzgjedhjen dhe qëndrimin në detyrë të magjistratëve edhe mungesën e një dënimi penal të formës së prerë. Ky vlerësim analitik përfshin ligjin që ishte në fuqi në momentin kur ndaj subjektit të rivlerësimit është marrë vendimi i dënimit penal të formës së prerë nga një gjykatë në Itali, por edhe ligjet e mëpasshme, përfshirë edhe ato të miratuara me paketën ligjore të miratuar në vitin 2016, që përbëjnë reformën në drejtësi. Më konkretisht, ligji nr. 8436, datë 28.12.1998<sup>2</sup>, në nenin 27, pika 3 parashikon shprehimisht si shkak shkarkimi të një gjyqtari një vendim penal të formës së prerë në ngarkim të tij/saj. Ekzistenca e një vendimi penal të formës së prerë në ngarkim të gjyqtarit, e përjashton këtë të fundit edhe nga kandidaturat për atë pozicion (neni 19, pika 4 e ligjit nr. 8436). Të njëjtin qëndrim shtrëngues dhe përjashtues, legjislatori e ka pasqyruar ndër vite, konkretisht në ligjin nr. 9877 të datës 18.02.2008, në nenet 11/ç dhe 20/c të tij dhe në ligjin për Gjykatën e Lartë nr. 8588, datë 15.03.2000, i ndryshuar. Pasja e një vendimi penal të formës së prerë ndaj gjyqtarit ka qenë shkak për shkarkimin e tij/saj në të gjitha ligjet e sipërcituara. Këto parime, së fundmi, janë sanksionuar edhe nga ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenet 104, 105 dhe 111 të cilat rikonfirmojnë që dënimi penal i formës së prerë është i papajtuashëm me funksionin e gjyqtarit, në cilëndo instancë. Në rastin konkret, trupi gjykues vlerëson se edhe nëse merren të mirëqena rrethanat që sipas pretendimit të subjektit, e shtynë të pranojë veprën penale për të cilën u dënua, standardet ligjore në fuqi atë vit dhe më pas,

<sup>2</sup> Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

por edhe përgjegjësia për të ruajtur integritetin personal, kërkojnë që ai minimalisht të raportonte në Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndodhinë, veprim që nuk rezulton të jetë ndërmarrë prej tij në asnjë rast vullnetarisht.

Trupi gjykues vëren se këto parashikime të ligjit janë jehonë edhe e standardeve më të përparuara ndërkombëtare, për sa i përket etikës gjyqësore. Sipas Parimeve të Bangalores për sjelljen e gjyqtarëve lidhur me integritetin, “[...] integriteti është parim kyç në kryerjen e detyrave të gjyqtarit”. Sipas paragrafit 101 të komentarit të këtyre parimeve<sup>3</sup>: “[...] Integriteti është cilësia e të qenit korrekt dhe e ndjekjes së rrugës së drejtë.” Komponentë të integritetit janë ndershmëria dhe morali gjyqësor. Gjyqtari duhet gjithmonë, dhe jo vetëm në kryerjen e detyrës, të veprojë me ndershmëri dhe në një mënyrë që nderon funksionin: të mos kryejë mashtrim, të mos gënjejë dhe të mos falsifikojë; të jetë i virtytshëm në sjellje dhe karakter. Nuk ka shkallë integriteti. Integriteti në gjyqësor është [...] nevojë. [...]”.

Siç shprehimisht shpjegon edhe ky komentari, prej gjyqtarit pritet një respekt skrupuloz për ligjin pasi, kur gjyqtari shkel ligjin, është reputacioni i gjyqësorit në tërësi që vihet në diskutim, pasi shkelja e ligjit inkurajon mungesë respekti për ligjin dhe dëmton besimin e publikut te vetë gjyqësori.<sup>4</sup>

Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues vëren se me gjithë kohën e gjatë që ka kaluar nga dënimi penal në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, fakti i ekzistencës së kësaj vepre penale është i papajtueshëm me funksionin e tij si gjyqtar në çfarëdo niveli. Ky vlerësim merr peshë veçanërisht domethënëse në rastin e një anëtari të Gjykatës së Lartë, i cili duke qenë në majat e profesionit ligjor dhe gjyqësor, ka detyrime proporcionalisht më të larta për të ruajtur besimin e publikut te drejtësia dhe shteti i së drejtës me veprimet brenda dhe jashtë zyrës. Për pasojë, administrimi dhe vlerësimi si provë nga Komisioni i vendimit të dënimit penal ndaj subjektit, është i bazuar në nenin 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016 dhe trupi gjykues vlerëson se vendimi i Komisionit për ta administruar këtë provë është i drejtë.

39. Subjekti i rivlerësimit pretendon se lidhur me vlerësimin e pasurisë, vendimi i Komisionit është i njëanshëm, i mbështetur vetëm në provat që ai vetë ka mbledhur, pa shqyrtuar dhe analizuar provat dhe pretendimet e tij. Kjo sjell cenim të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe konkretisht të parimeve të aksesit, të arsytimit të vendimit gjyqësor, të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.

39.1 Nga verifikimi i procedurave të zhvilluara në Komision, trupi gjykues konstaton se subjektit të rivlerësimit i janë respektuar të drejtat për një proces të rregullt dhe ligjor. Konkretisht, rezulton se subjektit të rivlerësimit në Komision i është garantuar e drejta e njohjes me aktet e administruara gjatë hetimit paraprak, që çështja e tij të dëgjohet publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Komisioni ka kryer analizën financiare, e cila është e bazuar<sup>5</sup> në: a) deklaratimet e bëra ndër vite nga ana e subjektit të rivlerësimit pranë ILDKPKI-së; b) provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; c) dokumentacione dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit; d) deklaratimet e bëra nga ana e subjektit të rivlerësimit, përmes postës elektronike, gjatë hetimit administrativ të kryer nga KPK-ja; e) provat shkresore të administruara nga institucionet publike dhe private; ë) çdo dokument tjetër që përben provë në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>3</sup>[https://www.unodc.org/res/ji/import/international\\_standards/commentary\\_on\\_the\\_bangalore\\_principles\\_of\\_judicial\\_conduct/bangalore\\_principles\\_english.pdf](https://www.unodc.org/res/ji/import/international_standards/commentary_on_the_bangalore_principles_of_judicial_conduct/bangalore_principles_english.pdf)

<sup>4</sup> Si më sipër, shih komentet 101, 108. Po ashtu, 3.2 dhe 109 të lexuara bashkë. “[...] Sjellja e gjyqtarit duhet të riafirmojë besimin e publikut në integritetin e gjyqësorit. Drejtësia duhet jo vetëm të jepet, por edhe të shihet që jepet.[...]”.

<sup>5</sup> Shih faqen 12 të vendimit të Komisionit.

Duke bërë një përmbledhje të përgjithshme të përllogaritjeve në bazë të të ardhurave neto të siguruara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nga aktiviteti profesional i bashkëshortes, rezultoi se në disa vite bilanci ishte negativ.

Fillimisht, periudha 1992-2002 nuk ishte përllogaritur në analizën financiare të kryer nga Komisioni, por u përllogarit me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, si dhe duke përdorur edhe të dhënat që ai paraqiti, të pasqyruara në analizën financiare të përpiluar nga ekspertët e zgjedhur prej tij, akti i të cilëve është administruara në dosje. Ky fakt, por jo vetëm<sup>6</sup>, tregon se provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit janë shqyrtuar dhe analizuar dhe vendimi është marrë bazuar edhe në pretendimet dhe provat e subjektit të rivlerësimit. Komisioni, në përputhje me nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, ka marrë në konsideratë provat dhe i ka vlerësuar sipas bindjes së tij për vlerën e tyre provuese. Këto veprime të Komisionit tregojnë qartë se janë respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor, të aksesit në gjykatë, të arsytimit të vendimit gjyqësor, të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.

40. Subjekti pretendon se konkluzionet që ka arritur Komisioni në vendim, bien ndesh me parimin e procesit të rregullt ligjor, duke cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë. Kështu, subjekti i është referuar jurisprudencës së GjEDNj-së, duke përmendur këtu çështjen *Allenet de Ribemont* kundër Francës, *Rushiti* kundër Austrisë, *Paraponiaris* kundër Greqisë, vendimet e të cilave konkludojnë se shprehja e çdo dyshimi të fajit është e papajtueshme me prezumimin e pafajësisë.

40.1 Në Aneksin e Kushtetutës, në nenin Dh, pika 3, parashikohet: “Nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”. Po aty, në pikën 4 të këtij neni, fjalja e dytë parashikon: “Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të bëjë deklaratime të pasakta, ose të fshehtë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”. Siç shihet, dy pika të ndryshme të të njëjtit nen, në kushte të caktuara, të përmendura më lart, prezumojnë masë disiplinore për subjektin e rivlerësimit. Më pas subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të provojë të kundërtën, që të “përmbysë” prezumimin në favor të shkarkimit. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka konstatuar se për të janë gjetur rrethanat e përcaktuara në nenin Dh, pikat 3 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës (shih më poshtë paragrafët 62.2, 63.1 dhe 63.2).

Ndërsa në nenin Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, parashikohet se barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti atë penal. Nëpërmjet barrës së provës, subjekti duhet të sigurojë provat dhe argumentet bindëse, si mekanizëm shpjegues për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Edhe Komisioni i Venecias në “Opinionin Amicus Curiae për ligjin e *vetting*-ut”, në paragrafin 41 të këtij opinion shprehet: “Neni Ç i Aneksit të Kushtetutës, në paragrafin 2 të tij, vendos shprehimisht mbi Komisionin e Pavarur dhe Kolegjin e Apelit detyrimin për të garantuar të drejtat e procesit të rregullt ligjor. Po ashtu, ndonëse në procesin e rivlerësimit, në disa raste, mund të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjektit të rivlerësimit i takon barra për të provuar të kundërtën, neni Ç i Aneksit të Kushtetutës parashikon qartë se kjo zbatohet vetëm për procedurën e rivlerësimit dhe jo për procedurat e tjera, dhe veçanërisht jo për procedurat penale”.

---

<sup>6</sup> Shih f. 19 të vendimit të Komisionit, analiza e provave të tjera të paraqitura nga subjekti dhe të pranuar nga Komisioni.

Në procesin e rivlerësimit, tri nene të Aneksit të Kushtetutës parashikojnë prezumimin në favor të masës disiplinore të pezullimit ose shkarkimit. Konkretisht, nenet D, pikat 4 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, që kanë të bëjnë me vlerësimin e pasurive; nenin Dh, pikat 3 dhe 4, që kanë të bëjnë me kontrollin e figurës; dhe nenin E, pikat 3, 4 dhe 5 që lidhen me vlerësimin e aftësive profesionale. Trupi gjykues, pasi analizoi shkakun e ankimit të subjektit dhe shqyrtoi dokumentacionin ligjor të ndodhur në dosje, arriti në përfundimin se vendimi i Komisionit është i bazuar në Aneksin e Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

41. Subjekti pretendon se vendimmarrja me dy standarde e Komisionit bie ndesh me jurisprudencën e GjEDNj-së. Sipas tij, kjo gjykatë ka konstatuar shkelje të nenit 6/1, për shkak të përsëritjes në vijueshmëri të vendimeve gjyqësore kontradiktore për çështje të njëjta të dhëna nga një gjykatë e vetme, të papajtueshme me parimin e sigurisë juridike.

41.1 Trupi gjykues, në analizimin e shkakut të mësipërm, konkludon se, në momentin që vendimi i Komisionit është objekt shqyrtimi në Kolegj, atëherë ai do të shqyrtohet dhe do të analizohet në funksion të çdo shkakut ankimor dhe, kur është rasti, do të orientohet edhe Komisioni në përputhje me nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme.

#### **IV. Analiza e trupit gjykues të Kolegjit për shkaqet procedurale të ankimit**

42. Subjekti pretendon se Komisioni nuk bazohet në fakte dhe rrethana të vërteta kur e shtyn seancën dëgjimore për shkak se subjekti i rivlerësimit kërkon më shumë kohë në dispozicion për të përgatitur mbrojtjen e tij, ndërkohë që, kur i ka dërguar njoftimin për seancën e re, në *e-mail* ka bashkëlidhur edhe metodikën e përdorur në kryerjen e analizës ekonomike të modifikuar në saje të dokumentacionit dhe shpjegimeve të marra nga ana e subjektit. Si rrjedhojë, Komisioni e ka shtyrë seancën jo për të përgatitur mbrojtjen subjektit, por për të realizuar vetë Komisioni një analizë ekonomike të re, të emërtuar “e modifikuar”.

42.1 Në përgjigje të shkakut si më sipër, trupi gjykues verifikoi pretendimet e ngritura dhe i rezultoi se Komisioni, më datë 28.06.2018, e njoftoi subjektin e rivlerësimit për seancën dëgjimore që do të zhvillohej më datë 04.07.2018. Subjekti i rivlerësimit, me *e-mail*-in e datës 29.06.2018, i kërkoi Komisionit më shumë kohë për t’u përgatitur për seancën dëgjimore. Komisioni, me *e-mail*-in e datës 03.07.2018, e njehej subjektin me analizën ekonomike të modifikuar, bazuar në dokumentacionin dhe shpjegimet e marra nga ana e tij dhe i njofton gjithashtu shtyrjen e seancës dëgjimore publike, më datë 10.07.2018.

Fakti që Komisioni ka modifikuar analizën, të cilën ia ka njoftuar edhe subjektit për t’u njohur me të dhe për t’u përgatitur për seancë publike, dëshmon qartë se i gjithë dokumentacioni dhe shpjegimet e dërguara të subjektit, pas rezultateve të hetimit, janë shqyrtuar duke sjellë si rezultat një analizë tjetër, të quajtur “e modifikuar”, për të cilën edhe subjekti është vënë në dijeni. Në bazë të sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se nga ana e Komisionit është respektuar parimi i kontradiktoritetit dhe parimi i aksesit në gjykatë, duke i dhënë mundësi subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime, si dhe të njihet dhe të prapësojë sërish rezultatet e reja të një analize të modifikuar.

Sa më sipër, shkakun i ngritur nga subjekti, nuk gjendet i bazuar.

43. Subjekti pretendon se detyrimi kushtetues për të plotësuar një deklaratë të re të detajuar të pasurisë (deklarata *vetting*) është dokumenti ligjor nga i cili do të fillojnë të evidentohen përgjegjësitë e subjekteve të rivlerësimit për shkelje disiplinore, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose përdorim, pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ndaj Komisioni ka juridiksion kushtetues dhe ligjor që të vlerësojë

pasurinë, duke u mbështetur vetëm në kontrollin e deklaratës *vetting*, kurse deklarimet periodike të pasurisë mund të përdoren si provë (*neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016*) dhe jo të jenë veçmas objekt kontrolli, por vetëm në funksion të krahasimit të të dhënave me deklaratën *vetting*.

**43.1** Në lidhje me shkakun e mësipërm, meqenëse deklarimet periodike të pasurisë mund të merren si provë nga Komisioni dhe Kolegji, të gjitha duhet t'i nënshtrohen kontrollit, verifikimit, krahasimit me deklaratën *vetting*, por edhe me njëra-tjetrën në deklarimet e pakësimeve dhe shtesave nëse përputhen edhe me dokumentacionin e bashkëlidhur, duke i shërbyer procesit në tërësi me kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit, si dhe përmbushjen e detyrimeve financiare. Nga kjo rrjedh arsyetimi se nuk mund të mos jenë objekt kontrolli edhe veçmas deklaratat periodike, për të arritur në konkluzionet nëse janë të sakta dhe të vërteta deklarimet e subjekteve të rivlerësimit, pasi saktësia dhe mjaftueshmëria janë tregues të cilët dalin nga krahasimi jo vetëm i pronave dhe i dokumenteve me deklaratën *vetting*, por edhe nga krahasimi i deklaratave periodike në vite me deklaratën *vetting*.

Jo vetëm për kriterin e pasurisë, por edhe për dy kriteret e tjera të procesit të rivlerësimit, është parashikuar plotësimi i deklaratës përkatëse brenda një afati të caktuar, por kjo nuk do të thotë që objekt kontrolli janë vetëm këto deklarata. Për kontrollin e aftësive profesionale, bashkë me deklaratën, janë objekt kontrolli edhe dokumente ligjore në vite<sup>7</sup>, sipas fashave të periudhave të kontrollit. Po kështu, edhe në kriterin e kontrollit të figurës, plotësohet deklarata si pikënisje e kontrollit të figurës, duke e mbështetur ose hedhur poshtë me prova të sakta, informacione konfidenciale, si dhe informacione të tjera të disponueshme.

Sa më sipër, trupi gjykues çmon se shkakun e ankimit i ngritur nga subjekti nuk gjendet i bazuar.

- 44.** Subjekti, nëpërmjet ankimit, pretendon se Komisioni në vendimin e tij analizon marrëdhënien juridike konsensuale mes individit dhe shoqërisë ndërtuese, ndërkohë që kontrata e shitjes është akt autentik ligjor, për sa i përket vullnetit, qëllimit dhe mënyrës së lidhjes së saj dhe ka fuqinë e ligjit për palët që e kanë nënshkruar atë (*neni 690 i Kodit Civil*).

**44.1** Sa i përket shkakut të mësipërm, trupi gjykues, ashtu si Komisioni, vlerëson se me të vërtetë në Kodin Civil (*neni 690*) parashikohet se kontrata ka fuqinë e ligjit për palët që e nënshkruajnë dhe, në rastin konkret, ka pasur vërtet një efekt të tillë për palët (shitës-blerës), pasi nuk kanë asnjë pretendim dhe është një kontratë që është ekzekutuar, sa u përket të drejtave dhe detyrimeve që janë parashikuar në të, por kjo nuk do të thotë që ka fuqinë e ligjit dhe është e padiskutueshme edhe për të tjerët, të cilët nuk janë palë në kontratë. Kjo nuk do të thotë se çmimet e parashikuara nga palët janë reale, pasi është një fakt i njohur që çmimet e shitblerjeve në kontrata janë vendosur me marrëveshje të palëve, dhe jo gjithmonë përfaqësojnë çmimin real, për të shmangur pagesën e tatimeve nga shitësi i pasurisë së paluajtshme. Analiza e marrëdhënies juridike mes subjektit dhe shoqërisë ndërtuese është bërë me të drejtë nga Komisioni, për faktin e çmimit nën kosto të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, objekt i marrëdhënies juridike.

Si rrjedhojë, pretendimi i mësipërm i subjektit nuk është bindës dhe i bazuar.

- 45.** Subjekti ankimon se pjesën më të madhe të vlerësimit të pasurisë në Komision e zë analizimi i dy pasurive, njëra me sipërfaqe 136 m<sup>2</sup> në Shkodër dhe tjetra me sipërfaqe 113

---

<sup>7</sup> Sipas *nenit 3, pika 2 e ligjit nr. 84/2016*, "dokument ligjor" është çdo dokument i përgatitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës profesionale, në veçanti vendim, raport/relacion, kërkesë për gjykim penal, mendim/opinion ligjor, si dhe akte të tjera që provojnë aftësinë profesionale të tij.



m<sup>2</sup> në Tiranë, të cilat nuk janë më në pronësinë e subjektit, pasi janë tjetërsuar para procesit të rivlerësimit dhe nuk janë as në përdorim të subjektit. Në këtë kuptim, subjekti pretendon që këto pasuri duhet të analizoheshin në kuadrin e burimit të ligjshëm që ka krijuar pasurinë.

**45.1** Trupi gjykues, në analizë të shkakut të mësipërm, duke u bazuar në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, çmon se për të verifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, Komisioni dhe Kolegji analizojnë këto pasuri, edhe pse nuk janë më pasuri ekzistuese dhe mund të jenë tjetërsuar nga subjekti i rivlerësimit ose personat e lidhur me të, të tretët. Komisioni me të drejtë i ka vlerësuar këto pasuri në kuadrin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të.

Sa më sipër, shkakun ankimor i ngritur nga subjekti, nuk është i bazuar.

46. Subjekti ankimor faktin se analiza e pasurisë në Komision është rezultat i një gjykimi të njëanshëm, mbështetur vetëm në provat që ka mbledhur, pa analizuar dhe shqyrtuar provat e subjektit të rivlerësimit, gjë që cenon parimet e procesit të rregullt gjyqësor, të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.

**46.1** Nga shqyrtimi i dokumentacionit që ndodhet në dosje, trupit gjykues i rezultoi se Komisioni, më datë 28.05.2018, e ka njoftuar subjektin mbi rezultatet e hetimit administrativ. Rezulton se subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit dhe në përpjekje për të provuar të kundërtën, ka paraqitur shpjegimet me shkrim, duke i shoqëruar me provat ku ka mbështetur pretendimet e tij. Rezulton gjithashtu se janë administruar provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, siç janë: analiza financiare e përpiluar nga ekspertët e zgjedhur prej tij dhe vërtetimi për pagesat e kryera nga institucionet për udhëtimet e tij të punës. Ndaj, me këto të drejta të ushtruara efektivisht nga subjekti i rivlerësimit, nuk mund të pretendohet për cenim të parimeve të procesit të rregullt gjyqësor, të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.

Sa më sipër shkakun ankimor i ngritur nga subjekti, nuk është i bazuar.

47. Subjekti pretendon se nga vendimi i Komisionit nuk rezulton në asnjë pikë të tij të ketë konstatuar kundërshti apo mospërputhje deklarimesh ndërmjet deklaratës *vetting* dhe deklaratave periodike të pasurisë.

**47.1** Mospërputhjet që i kanë rezultuar Komisionit, lidhur me subjektin e rivlerësimit, janë deklaratimet periodike në raport me dokumentacionin mbështetës të këtyre deklarimeve, saktësisht çmimet e kontratave të shitblerjes së dy apartamenteve të banimit, një në Shkodër me sipërfaqe 136 m<sup>2</sup> dhe një në Tiranë me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup>, si dhe garazhi për të cilin Komisioni ka konstatuar që nuk është deklaruar nga subjekti, ndër vite, të cilat janë trajtuar më vete nga Komisioni dhe, si rrjedhojë, janë ngritur edhe si shkaqe ankimi më vete. Në analizë të këtij shkak, bazuar në dokumentacionin që ndodhet në dosje, trupi gjykues ka konstatuar këto mospërputhje lidhur me çmimet e kontratave të shitblerjes së apartamenteve në fjalë dhe ekzistencën e garazhit, të analizuar nga Komisioni. Trupi gjykues ka konstatuar mosrespektim nga ana e subjektit të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", konkretisht nenin 4 të tij, pasi fillimisht subjekti nuk ka deklaruar garazhin në Shkodër, më pas ka deklaruar vlera të pasurive që nuk përputhen me vlerat e kontratave të shitblerjes së tyre.

Sa më sipër, shkakun ankimor i ngritur nga subjekti, nuk është i bazuar.

48. Një pretendim tjetër i subjektit është se juridiksioni dhe kompetenca me të cilat Kushtetuta dhe ligji e kanë ngarkuar Komisionin për të ushtruar procesin e rivlerësimit, nuk mund të kufizohet dhe të jetë vetëm gjetja e gabimeve ndër vite të subjekteve që rivlerësohen. Madje duhet që Komisioni këto pasaktësi t'i identifikojë nëse janë ato me të cilat subjekti i rivlerësimit fsheh pasurinë apo burimin e krijimit të saj.

48.1 Lidhur me shkakun e mësipërm, trupi gjykues, ashtu si Komisioni, i bazon gjetjet e tij në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, në të cilën parashikohet se subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar *saktësisht dhe plotësisht* pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Ndaj qëllimi i ligjit dhe i Kushtetutës nuk është që të identifikohen vetëm ata të cilët kanë fshehur pasurinë, por edhe ata të cilët kanë deklaruar në mënyrë të pasaktë dhe të paplotë pasuritë e tyre. Konstatimi i këtyre pasaktësive përfaqëson në vlerësimin e Kolegjit një sjellje dhe qasje konstante të subjektit në raport me deklaramin e pasurisë së tij ndër vite dhe në deklaratën *vetting*. Për këtë arsye, ndaj tij konsiderohet se, me të drejtë Komisioni zbatoi parimin e prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti kishte detyrimin të provonte të kundërtën, sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

Si rrjedhojë, shkakun e mësipërm i subjektit, nuk është i bazuar.

49. Subjekti pretendon se referuar nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile – “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarameve që janë bërë përpara tyre, për fakte që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre.” – faqja 4 e formularit A1 të deklaratës vjetore të vitit 2004, përbën provë të plotë dhe të pakontestueshme.

49.1 Trupi gjykues vëren se, ashtu siç përshkruan edhe vetë subjekti, neni 253 i Kodit të Procedurës Civile u referohet akteve zyrtare që përpilohen nga nëpunësi publik. Nga verifikimi i dokumentacionit që ndodhet në dosje, trupit gjykues i rezultoi se në rastin konkret, formulari A1, faqja 4 e deklaramit të subjektit të deklaramit vjetor të vitit 2004, duke qenë formular i plotësuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, nuk përbën akt të përpiluar nga nëpunësi publik. Gjithashtu, akti përbën provë të plotë kur deklaramet janë bërë para nëpunësve për fakte që kanë ngjarë në prani të tyre, ndërkohë deklaramta e personit që mbart detyrimin për deklaramin e pasurisë është një formular i cili i nënshtrohet kontrollit nga vetë ILDKPKI-ja. Në nenin 25 të ligjit nr. 9049 parashikohet: “Kontrolli aritmetik dhe logjik kryhet për çdo deklaram për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaramuar, saktësinë e burimeve financiare të deklaramuara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurive nga burime të deklaramuara”. Pra, deklaramet e pasurisë janë formularë të deklaramit të pasurive dhe të burimit të krijimit të tyre, të cilët i nënshtrohen kontrollit, ndaj dhe nuk përbëjnë akt zyrtar, në kuptim të fuqisë provuese të parashikuar nga neni 253 i Kodit të Procedurës Civile.

Sa i përket shkakut të mësipërm të subjektit, nuk është i bazuar.

## **Shkaqet ankimore në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë dhe analizimi i tyre**

### ***Shkaqet ankimore në lidhje me pasurinë nr. 1 dhe analizimi i tyre***

Apartament banimi 3 + 1, me sipërfaqe 136 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën {\*\*\*}, Shkodër, fituar me kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*}rep. dhe {\*\*\*}85 kol., datë 06.04.2000, regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër (në vijim ZVRPP Shkodër), më datë 18.05.2000.

Deklaruar në deklaratën *vetting*, si dhe në deklaratën e vitit 2003 me vlerë 3.000.000 lekë dhe me pjesë takuese {\*\*\*} %.

Burimi i deklaruar në vitin 2003: Shitja e dy apartamenteve të tjera të banimit, 2 + 1 dhe 1 + 1. Apartamenti 2 + 1 buron nga privatizimi i banesave shtetërore në Shkodër, ndërsa apartamenti 1 + 1 është blerë me të ardhura nga puna e biznesit privat si notere e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

Burimi i deklaruar në deklaratën *vetting*: të ardhurat nga puna e subjektit dhe aktiviteti privat i bashkëshortes, si dhe nga shitja e apartamenteve 1 + 1 dhe 2 + 1 në Shkodër, më datë 16.11.2000.

Komisioni ka ngritur disa probleme lidhur me këtë pasuri, të cilat kanë të bëjnë me çmimin e blerjes së apartamentit, i cili rezulton të jetë disa herë më i ulët se vlera normale e tregut në vitin 2000. Ky çmim bën të duket një trajtim preferencial. Qëndrimi i subjektit, lidhur me qenien e apartamentit në gjendje karabina në momentin e blerjes, nuk rezulton bindës, madje një gjë e tillë nuk pasqyrohet as në kontratën e shitjes. Kjo bindje përforcohet edhe nga prania e dy faqeve me nr. 4 të formularit “A1” në deklaratën e vitit 2003, fakt të cilin subjekti nuk e mban mend, por as e kundërshton.

Konkluzionet e Komisionit lidhur me këtë pasuri:

*Nga hetimi administrativ rezultoi ekzistenca e deklaratimit të pamjaftueshëm, të paplotë, të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, si dhe shpjegime kontradiktore dhe jobindëse; mungesë e disponibilitetit në blerjen e kësaj pasurie, mungesë e burimit financiar me prejardhje nga shitja e dy apartamenteve, të deklaruar që janë përdorur si burim për pagesën e blerjes së pasurisë nr. 1.*

*Këto veprime rezultojnë të jenë kryer në mosrespektim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, si dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, që për rrjedhojë çojnë në aplikimin e nenit 61, pika 3 e po këtij ligji.*

50. Subjekti pretendon se vlera e blerjes së apartamentit – 1.200.000 lekë, duke shtuar edhe vlerën e rikonstruksionit 1.800.000 lekë – është vlera reale e investimit për këtë apartament. Subjekti shprehet se: “[...] për të qenë më i saktë, përveç vlerës së blerjes së apartamentit, kam deklaruar vullnetarisht edhe shpenzimet”. Sipas tij, ai ka bërë një deklaram të plotë dhe real të vlerës së apartamentit në zbatim të ligjit nr. 9049, në deklarimin e parë në vitin 2003. Sipas subjektit, do të përbënte shkelje nëse ai do të kishte deklaruar vetëm çmimin e blerjes së apartamentit pa shpenzimet e tjera që janë bërë për rregullime, me të ardhura të ligjshme. Subjekti pretendon se, në kundërshtim me detyrimet kushtetuese dhe ligjore, Komisioni nuk bën analizë nëse kjo pasuri është e justifikuar me të ardhurat e tij të ligjshme.

50.1 Në analizë të shkakut të mësipërm, trupit gjykues i rezulton se çmimi i blerjes është shumë më i lirë se çmimi i rikonstruksionit (shiko paragrafin 47.1), siç pretendon subjekti. Komisioni ka vërejtur se vlera prej 1.800.000 lekësh për rikonstruksion, apo arredim, është një vlerë relativisht e madhe për vitin 2000, krahasuar me koston mesatare të ndërtimit për këtë vit, sipas VKM-së nr. 362, datë 14.07.2000, për një pallat të sapondërtuar, ku nevoja për rikonstruksion nuk është e madhe. Nga kontrata e shitblerjes së këtij apartamenti, nuk rezulton që ai të jetë blerë në gjendje të pabanueshme, ndaj çmimi i referuar në kontratë duket joreal. Subjekti ka kryer veprime në mosrespektim të ligjit nr. 9049/2003, si dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 që, për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se në këtë rast gjen vend aplikimi i nenit 61, pika 3 e po këtij ligji dhe se konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri janë të bazuara në ligj dhe prova.

Sa më sipër, shkak i ngritur nga subjekti, nuk është i bazuar.

**50.2** Sa u përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me burimet e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie, trupi gjykues vëren se Komisioni ka arritur në përfundimin: “a) apartamenti i blerë nga subjekti është pjesë përbërëse e një pallati që përmban një numër të caktuar apartamentesh, të regjistruara më 17.05.2000 në ZRVRP Shkodër; b) regjistrimi i pallatit është kryer pas disa procedurave, siç janë kolaudimi, certifikimi i ndërtesës për banim, që do të thotë kur pallati kolaudohet, i ka të gjitha punimet e kryera dhe funksionale; c) në kontratën e shitblerjes 06.04.2000, nuk përmendet që apartamenti të ketë qenë në gjendjen karabina, përkundrazi aty shtjellohet se sendi mund të gëzohej menjëherë nga blerësi, pasi ishte i lirë nga çdo barrë dhe hipotekë; d) duke iu kthyer kontratave të shitblerjes së dy apartamenteve të tjera të banimit, 2 + 1 dhe 1 + 1, që kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë apartament banimi 3 + 1, shuma totale e të dyja shitjeve ka sjellë shumën prej 1.100.000 l (një milion e njëqind mijë) lekësh (600.000 lekë + 500.000 lekë), ndërsa shpenzimi që pretendon subjekti se ka bërë me këtë burim financiar, rezulton të jetë 1,8 milionë lekë”.

Për këtë shkak ankimor, është kryer analiza financiare në Kolegj. Trupi gjykues vëren se edhe nëse subjekti, siç ka deklaruar, ka shpenzuar 1.800.000 lekë, një pjesë e shumës së shpenzuar, konkretisht 700.000 (shtatëqind mijë) lekë, është e pajustificuar nga burime të ligjshme.

Për periudhën kohore 1992-2003, situata financiare e subjektit ka rezultuar me diferencë negative prej -1.339.708,69 lekësh dhe, rrjedhimisht, pasuria nuk është e justifikuar me të ardhura të ligjshme.

Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se shkak i ankimit i ngritur nga subjekti, nuk është i bazuar.

- 51.** Subjekti ankimon konstatimin e Komisionit se çmimi i pasqyruar në kontratë (1.200.000 lekë) është shumë më i vogël në krahasim me çmimin mesatar të tregut, nuk është i bazuar në ligj dhe në prova. Për të vlerësuar nëse çmimi ishte i ulët apo jo, pretendon subjekti, Komisioni duhet t'i ishte referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 362, datë 14.07.2000, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe koeficientit K”. Kjo VKM përcakton se çmimi mesatar i koston së ndërtimit në tregun e lirë, në qytetin e Shkodrës, për vitin 2000 është 25.825 lekë për m<sup>2</sup>. Duke e shumëzuar këtë kosto me sipërfaqen në metra katrorë të deklaruar, rezulton se çmimi mesatar i tregut të lirë për qytetin e Shkodrës për këtë sipërfaqe, në vitin 2000, ka qenë 3.512.200 lekë, i përafërt me koston e ndërtimit të apartamentit të banimit të deklaruar nga subjekti.

**51.1** Në kontratën e shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep. dhe {\*\*\*} kol., datë 06.04.2000, përcaktohet se shitësi {\*\*\*} u shet blerësve një apartament banimi, i përbërë nga tri dhoma gjumi, një dhomë ndenjeje, aneks, korridor, dy banjo, dy ballkone, gjithsej me sipërfaqe 140 m<sup>2</sup>, si dhe një garazh me sipërfaqe 18 m<sup>2</sup>. Çmimi i përcaktuar është 1.200.000, shumë e cila është paguar e plotë nga ana e blerësit, si dhe i ka kaluar sendi në gëzim dhe disponim të plotë.

Nga shpjegimet që ka dhënë subjekti pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, rezulton se apartamentin e banimit me sipërfaqe 136 m<sup>2</sup>, i ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Shkodër, (së bashku me garazhin), e ka blerë nga Shoqëria {\*\*\*} SHPK në prill 2000, karabina, pra të papërfunduar për banim dhe, për këtë arsye, kontrata e shitblerjes pasqyron çmimin e shitjes së apartamentit prej 1.200.000 lekësh, në gjendjen që është marrë. Me qëllim që apartamenti të bëhej i banueshëm, sipas subjektit, janë bërë punime ndërtimore shtesë, të cilat shkonin rreth 1.800.000 lekë (shtrim dhe veshje pllakash, punime hidraulike dhe elektrike, hidrosanitare cilësore, gipsi, dyer dhe dritare të jashtme

duralumini cilësore, dyer të brendshme druri cilësore, disa ndryshime strukturore të brendshme, sisteme kondicionimi etj.).

Subjekti ka pretenduar se apartamenti bashkë me garazhin, që janë afërsisht 158 m<sup>2</sup>, janë blerë me çmim 1.200.000 lekë në gjendjen karabina, duke pretenduar se vlera tjetër prej 1.800.000 lekësh është shpenzuar për të përfunduar apartamentin, i cili në total shkon në vlerën 3.000.000 lekë. Duke iu referuar VKM-së nr. 362, datë 14.07.2000, e cila miraton vlerën e kostos mesatare të ndërtimit në shkallë rrethi, meqenëse në këtë periudhë nuk kemi çmime reference për zonat kadastrale, në zonën e Shkodrës kjo vlerë kostoje për sipërfaqe ndërtimi në vitin 2000 është 25.825 lekë/m<sup>2</sup>. Kjo vlerë po të shumëzohet me metrat katrorë të sipërfaqes së apartamentit + garazh (25825 L/m<sup>2</sup> x 158 m<sup>2</sup>) rezulton prodhimi 4.080.350 lekë vlerë kostoje ndërtimi.

Trupi gjykues arsyeton se edhe sikur të merren të mirëqena pretendimet e subjektit që apartamenti është blerë karabina, vlera mesatare e koston së ndërtimit të këtij apartamenti për vitin 2000, në rrethin e Shkodrës, është 4.080.350 lekë për 158 m<sup>2</sup>, sipërfaqe apartament + garazh, kjo sipas VKM-së nr. 362, datë 14.07.2000, që këtej rezulton se kostoja e ndërtimit të apartamentit në këtë periudhë është më e lartë se çmimi që ka deklaruar subjekti për blerjen e karabinasë + veshje strukturore dhe arredim. Në këtë pikë, bën të duket si çmim preferencial për subjektin, pasi apartamenti rezulton të jetë shitur nga shoqëria {\*\*\*} SHPK nën koston e ndërtimit.

52. Subjekti ankimon edhe konstatimin tjetër të Komisionit: “Çmimi i deklaruar 3.000.000 lekë për blerjen e apartamentit dhe garazhit rezulton të ketë qenë sa gjysma e çmimit të tregut në atë vit”. Sipas subjektit, ky është një konstatim sa i gabuar ligjërish, edhe i pabazuar në prova. Subjekti pretendon se këto konstatime janë të njëanshme, subjektive dhe kanë për qëllim ta rendojnë padrejtësisht, duke pasqyruar në mënyrë të deformuar realitetin, në referencë edhe të standardit të vendosur tashmë prej Komisionit në raste të ngjashme. Komisioni, sipas subjektit, bazuar në nenin 50 të ligjit nr. 84/2016, duhet t’i kishte kërkuar informacion ZVRPP-së Shkodër, në lidhje me çmimin e transaksioneve të pronave të tjera kufitare, dhe vetëm pas krahasimit të këtyre kontratave të arrinte në konkluzionin e saktë, lidhur me çmimin mesatar të tregut në atë periudhë, në qytetin e Shkodrës. Sipas tij, për periudhën e lidhjes së kësaj kontrate, nuk ka pasur përcaktime ligjore për çmim të detyrueshëm reference.

52.1 Trupi gjykues konstaton se për vitin 2000, çmimi i tregut për shitjen e pasurive të paluajtshme, përcaktohej në bazë të transaksioneve të regjistruara në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në këtë periudhë. Komisioni, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 11.4.2018, i është drejtuar ZVRPP-së Shkodër për të marrë një informacion në lidhje me transaksionet e pasurive të paluajtshme në vitin 2000, meqë nuk ka pasur çmim të detyrueshëm reference. Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 16.04.2018, ZVRPP Shkodër i përgjigjet Komisionit: “Çmimi i blerjes për apartamente në vitin 2000, në qytetin e Shkodrës është kostoja 32.443 lekë/m<sup>2</sup>.”

Trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka kryer hetimet përkatëse në lidhje me këtë pasuri dhe se konstatimet e Komisionit janë të bazuara në ligj dhe në prova. Sa më sipër, pretendimi i subjektit nuk gjendet i bazuar.

53. Subjekti ngre si shkak ankimor dy konkluzione të Komisionit që i kundërshton së bashku për vete relevancën që kanë: a) në deklaratën e vitit 2003 mungon deklarimi i garazhit; b) modifikimi i bërë në njërin nga formularët “A1”, në faqen 4, nuk është bërë në përputhje me procedurat dhe udhëzimet e institucionit përkatës, pasi mungon një procesverbal që të pasqyrojë këtë ndërhyrje në një dosje të administruar. Subjekti ankimon faktin se Komisioni analizon veçmas deklaratën e vitit 2003, pa e krahasuar atë me deklaratën *vetting*, dhe faktin që Komisioni, në kundërshtim me ligjin nr. 9049/2003, e ngarkon me përgjegjësinë e mungesës së një procesverbali, i cili duhet të ishte plotësuar dhe

administruar në dosjen e subjektit nga ILDKPKI-ja. Detyrimin ligjor për të verifikuar rregullsinë e plotësimit të deklaratës, e kishte ILDKPKI-ja, si dhe të kryente përpunimin paraprak të saj (sipas nenit 24 të ligjit nr. 9049) dhe, sipas rastit, të bënte edhe plotësime për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.

**53.1.** Në deklaratën e vitit 2003, dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit më datë 17.03.2004, ka dy formularë A1, të cilët mbajnë të dy nr. 4 të faqes. Ndërkohë, nuk rezulton në numërtimin e faqeve numri 2. Për rrjedhojë, konstatohet një rreshtim faqesh si vijon: “1, 3, 4, 4...”. Formulari A1 është plotësuar dy herë nga subjekti i rivlerësimit. I pari në datën 17.03.2004 dhe i dyti në datën 29.01.2005. Në shtyllën e parë të përshkrimit të pasurisë, ku është shënuar “apartament banimi 3 + 1 (136 m<sup>2</sup>)”, është shtuar “+18 m<sup>2</sup> garazh”, kurse te shtylla {\*\*\*} e këtij formulari është detajuar vlera e blerjes 1,2 milionë lekë, si dhe vlera e rikonstruksionit 1,8 milionë lekë. Ndër shpjegimet që ka dhënë subjekti pas kalimit të barrës së provës, është shprehur se nuk kujton arsyen e ekzistencës së dy formularëve A1 për të njëjtën pronë, me të dhëna të ndryshme, pasi kanë kaluar 15 vite dhe këta formularë administrohen nga ILDKPKI-ja, ndaj ka qenë detyrim i institucionit të verifikonte rregullsinë e plotësimit.

Referuar nenit 24 të ligjit nr. 9049, paragrafi i dytë i këtij neni parashikon: “Kur nga përpunimi paraprak vërtetohen gabime materiale, mospërputhje midis deklaratës së dorëzuar personalisht në formë fizike dhe deklaratës së dorëzuar me mjete të komunikimit elektronik, ose plotësime të gabuara, Inspektorati njofton subjektin që ka paraqitur këto deklarime, i cili, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, është i detyruar t’i ndreqë ato”. Nga ky paragraf del se në rast të gabimeve materiale, mospërputhjeve, si dhe plotësimeve të gabuara duhet të ndreqen brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit. Ndërkohë, afati i kaluar nga data e dorëzimit të deklaratës, 17.03.2004, deri në datën e nënshkrimit të formularit të dytë A1 që mban datën 29.01.2005, është relativisht një kohë e gjatë ndërmjet tyre për të pretenduar ndreqjen e gabimeve, nëse mund të konsiderohen të tilla, pasi ndryshimet në formularë janë shtesa dhe jo gabime materiale. Sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe ligjor vendimin e Komisionit.

54. Subjekti pretendon se vërtetësinë e formularit A1 të vitit 2003 e konfirmon edhe vetë ILDKPKI-ja, e cila në raportin përfundimtar të kontrollit të pasurisë e vlerëson të mirëqenë dhe të saktë deklarimin e garazhit që në vitin 2003, dhe njëkohësisht edhe vlefshmërinë e këtij formulari. Ky qëndrim bie ndesh edhe me interpretimet kushtetuese të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, e cila ka theksuar se gabimet për mosplotësimin e detyrimeve ligjore të administratës nuk mund të ngarkojnë me përgjegjësi dhe as t’i cenojnë ato në të drejtat e tyre, këtu referon edhe vendimin nr. 32, datë 22.07.2011, të Gjykatës Kushtetuese.

**54.1** Në lidhje me vërtetësinë e formularit, nuk ka asnjë qëndrim nga ana e ILDKPKI-së në raportin e përfundimit të kontrollit me nr. {\*\*\*} prot., datë 17.11.2017, i cili për këtë pasuri citon: “[...] *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP Shkodër, lidhur me apartamentin 136 m<sup>2</sup>, i cili rezulton të jetë shitur pas dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit. Lidhur me garazhin me sip. 18 m<sup>2</sup>, të deklaruar nga subjekti, nuk rezulton të jetë i regjistruar në ZVRPP, para datës 02.05.2017 (përfutur me kontratë dhurimi)[...].* Nga raporti i ILDKPKI-së nuk mbahet ndonjë qëndrim apo të saktësohet pse formulari A1 është i dublikuar, gjithashtu në dosje nuk ka ndonjë procesverbal që të sqarojë plotësimin e dy formularëve, si dhe një gjë e tillë nuk është kërkuar as nga Komisioni.

Në lidhje me vendimin nr. 32, datë 22.07.2011, të Gjykatës Kushtetuese që ka referuar subjektin, gjykata shprehet: “Veprimet ose mosveprimet e parregullta të administratës gjyqësore nuk duhet t’i ngarkohen individit, i cili nuk mund të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së saj (administratës)”. Ky konkluzion i gjykatës vjen si rrjedhojë e

veprimeve të administratës gjyqësore me vonesë, aq sa t'i mohojë kërkuesit aksesin në gjykatë, duke i mohuar kështu të drejtën për t'u dëgjuar në një seancë publike nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj. Trupi gjykues vlerëson se vendimi nr. 32, datë 22.07.2011, i Gjykatës Kushtetuese nuk duket se ka lidhje me shkakun e ngritur dhe mbrojtur nga subjekti i rivlerësimit, pasi edhe pse ILDKPKI-ja duhet ose mund të ketë mbajtur procesverbal për fletën tjetër të plotësuar për herë të dytë, por gjithsesi subjekti duhet të shpjegonte arsyen pse formulari është plotësuar dy herë në kohë të ndryshme.

55. Lidhur me rezultatin e Komisionit se të ardhurat nga shitja të realizuara në nëntor 2000, nuk mund të përdorëshin për blerjen e apartamentit të realizuar në prill të vitit 2000, subjekti pretendon se Komisioni nuk e ka marrë parasysht deklarimin e burimit në deklaratën *vetting*, ku është deklaruar se për krijimin e këtij apartamenti, me sipërfaqe 136 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Shkodër, kanë shërbyer të ardhurat nga *paga ime, aktiviteti privat i b/shortes sime dhe nga shitja e apartamenteve*. Që këtej subjekti shpjegon se çmimi i blerjes së apartamentit dhe garazhit prej 1.200.000 lekësh, i është likuiduar shoqërisë {\*\*\*} SHPK në datën e lidhjes së kontratës nga të ardhurat familjare, ndërsa pjesa tjetër me shitjen e dy apartamenteve në nëntor 2000, ku janë mbuluar shpenzimet e punimeve.

55.1 Po t'i referohemi deklaratës së vitit 2003, për këtë apartament subjekti ka deklaruar burim “përfitimet nga shitja e dy apartamenteve, 2 + 1 dhe 1 + 1 në Shkodër, të shitur më datë 16.11.2000. Duke qenë se pasuria në shqyrtim (136 m<sup>2</sup> në Shkodër) është blerë në prill të vitit 2000 dhe burimi i deklaruar është krijuar në nëntor të vitit 2000, subjekti në deklaratën *vetting* ka bërë një ndryshim të burimit duke shtuar edhe të ardhurat e tij, si dhe të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortes në momentin e likuidimit të çmimit të kontratës, ndërsa me shitjen e dy apartamenteve të tjera ka likuiduar vlerën e rikonstruksionit prej 1.800.000 lekësh. Trupi gjykues arrin në përfundimin se ka pasaktësi në deklarimin e burimit të pasurisë.

Sa i përket shkakut të mësipërm, nuk gjendet i bazuar.

56. Subjekti ankimon konstatimin e Komisionit në f. 8, pika d: “se një pjesë e shpenzimeve prej 800.000 lekësh, është e pajustificuar me burime të ligjshme”. Për të vlerësuar nëse subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme, Komisioni duhet t'i referohej analizës financiare për periudhën 1992-1999, periudhë në të cilën subjekti ka pasur disponibilitet të ardhurash në vlerën 2923861 lekë, të siguruara nga të ardhurat e punës së tij dhe të bashkëshortes (pa përfshirë të ardhurat nga shitja e apartamentit në vlerën 500.000 lekë).

- 56.1 Referuar analizës financiare për pasurinë nr. 1, nga përlllogaritja rezulton se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë, shpenzimet dhe kursimet e krijuara gjatë viteve 1992-2003, në shumën -1.339.709 lekë. Pasuria nr. 1 është blerë në këtë segment kohor të përlllogaritjes, saktësisht në vitin 2000, ndaj dhe të ardhurat rezultojnë të jenë të pamjaftueshme për të krijuar këtë pasuri.

Trupi gjykues në analizë të fakteve dhe provave arrin në përfundimin se, lidhur me pasurinë e trajtuar si pasuria nr. 1, apartament banimi 3 + 1, me sipërfaqe 136 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën {\*\*\*}, Shkodër, fituar me kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep. dhe {\*\*\*} kol., datë 06.04.2000, regjistruar në ZRPP Shkodër me numër pasurie {\*\*\*}, më datë 18.05.2000, subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë e tij dhe nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë. Situata faktike kjo që, në përputhje me parashikimet e nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, në lidhje me nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, parashikohet të prezumohet në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Rrjedhimisht, me të drejtë Komisioni bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr.

84/2016, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit pasi rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë.

### ***Shkaqet ankimore në lidhje me pasurinë nr. 2 dhe analizimi i tyre***

57. Subjekti pretendon se kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *vetting*, si një nga burimet për krijimin e pasurisë me sipërfaqe 149 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë, prandaj Komisioni kishte detyrimin e analizimit të saj vetëm në kuadrin e burimit të ligjshëm dhe jo të analizonte veçmas mënyrën e deklaramit të kësaj pasurie në deklaratën e vitit 2003.

57.1 Lidhur me shkakun e mësipërm, trupi gjykues, duke pasur parasysh parashikimin e nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me objektin e vlerësimit të pasurisë, sipas të cilit: “[...] është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij [...]”, çmon se këto elemente rezultojnë edhe nga deklaramet periodike të pasurisë së subjekteve të rivlerësimit. Duke qenë pjesë e objektit të kriterit të kontrollit të pasurisë edhe ligjshmëria e burimit të krijimit, detyrimisht duhet të analizohen veçmas edhe pasuritë të cilat kanë shërbyer si burim i krijimit të një pasurie tjetër, proces i cili jo pa qëllim e fillon analizën që nga viti 2003. Trupi gjykues vëren se pasuritë të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë apartament banimi, me sipërfaqe 149 m<sup>2</sup>, parë në këndvështrimin e nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, janë detyrimisht pjesë e vlerësimit dhe e kontrollit të pasurive ekzistuese. Për këtë arsye, trupi gjykues e gjen të drejte qëndrimin e Komisionit në drejtim të analizës dhe kontrollit të këtyre pasurive.

Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se shkakun i ankimit i ngritur nga subjekti, nuk është i bazuar.

58. Në vendim, Komisioni konstaton: i) *Çmimi i apartamentit në rr. {\*\*\*}, me sipërfaqe 149 m<sup>2</sup>, i deklaruar në vlerën 4.000.000 lekë, në deklaratën e vitit 2003, nuk përputhet me atë të pasqyruar në kontratën e shitblerjes, që ka rezultuar se ishte 1.950.000 lekë.*

Subjekti ankimon këtë rezultat të Komisionit dhe pretendon se ai në deklaratën e parë, 2003, ka bërë një deklaram të plotë dhe real, madje përveç çmimit të blerjes, ka deklaruar edhe shpenzimet për rregullimet ndërtimore, që si investim në total është 4.000.000 lekë. Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *vetting* si një nga burimet e krijimit të pasurisë apartament, me sipërfaqe 149 m<sup>2</sup> (aktualisht në pronësi të subjektit) dhe jo të analizohet veçmas për mënyrën e deklaramit të kësaj pasurie, në deklaratën e vitit 2003.

#### **58.1 Konkluzionet e Komisionit lidhur me këtë pasuri:**

*Rezulton e provuar ekzistenca e një çmimi fiktiv në kontratën e shitblerjes, ose e një deklarimi të pamjaftueshëm në ILDKPKI, pasi çmimi është pasqyruar më tepër se dyfishi i atij që rezulton nga kontrata, pa provuar kryerjen e shpenzimeve për punimet e pretenduara.*

*Këto veprime rezultojnë të jenë kryer në mosrespektim të ligjit nr. 9049, si dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 që, për rrjedhojë, çojnë në aplikimin e nenit 61, pika 3 e po këtij ligji.*

58.2 Trupi i gjykues analizoi shkakun e mësipërm dhe si rezultat vëren se apartamenti me të dhënat e mësipërme është blerë në vitin 2003, në vlerën 1.950.000 lekë, kohë e cila nuk ka pasur çmime reference të aplikueshme sipas zonave kadastrale. Në vitin 2003, kohë kur është blerë prona, ka pasur tatim për kalimin e të drejtës së pasurisë së paluajtshme, i cili – bazuar në nenin 11 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar – llogaritej mbi totalin e çmimit të shitjes sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij ligji. Duke iu referuar vlerës së deklaruar në kontratë dhe tabelës që i bashkëlidhet ligjit nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka



preferuar të qëndrojnë në vlerat minimale të pagimit të tatimit për kalimin e të drejtës së pronësisë, konkretisht në 0,5% tatim të çmimit të shitjes. Nga kjo rrjedh se nga totali i çmimit 4.000.000 lekë, të deklaruar në deklarin e parë në vitin 2003, çmimi i blerjes së apartamentit të jetë më i vogël se restaurimet që janë bërë pas blerjes. Ndërkohë, subjekti nuk ka sjellë fatura për të provuar shpenzimet e pretenduara. Megjithëse ka në vëmendje kohën e gjatë që ka kaluar, trupi gjykues vëren që pretendimi se vlera e rregullimeve ka kaluar vlerën e blerjes së apartamentit me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup> në {\*\*\*}, Tiranë, me {\*\*\*}%, bie ndesh me logjikën e thjeshtë ekonomike dhe përlllogaritjet e arsyeshme.

**58.3** Nga ana tjetër, duke u bazuar në Udhëzimin nr. 1, datë 08.05.2003, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe koeficientit K”, në tabelën nr. 2, ku përcaktohen të dhënat në tregun e lirë të banesave, për qytetin e Tiranës është 53.450 lekë/m<sup>2</sup> për sipërfaqe shfrytëzimi. Një përlllogaritje e sipërfaqes së apartamentit të mësipërm (113 m<sup>2</sup>), shumëzuar me vlerën 53.450 lekë/m<sup>2</sup>, rezulton 6.039.850 lekë në total, një vlerë që është pothuajse trefishi i çmimit të caktuar në kontratë. Nga kjo diferencë e konsiderueshme mes çmimit të përcaktuar në kontratë dhe çmimit që rezulton në tregun e lirë në vitin 2003 për Tiranën, trupi gjykues çmon se duhet të ketë pasur dakordësinë mes palëve për të shkruar në kontratë një çmim më të ulët, të cilit i korrespondon minimumi i tatimit mbi fitimin.

Sa i përket shkakut ankimor të mësipërm të subjektit, nuk gjendet i bazuar.

- 59.** Subjekti pretendon se për këtë pasuri, hamendësimet e ngritura nga Komisioni në vendim, nuk arrijnë nivel provueshmërie dhe se deklarimi vjetor i vitit 2003, duhej të vlerësohej *si provë*, duke u bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**59.1** Në lidhje me shkakun e mësipërm, trupi gjykues i referohet nenit 45, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: “[...] Komisioni, Kolegji dhe vëzhguesit ndërkombëtarë administrojnë dokumentet që u vërtetojnë veprime, fakte, cilësi ose një situatë subjektive të nevojshme për realizimin e hetimit [...]”. Vërtet deklarinet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë në ILDKPKI, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji, sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, por mbetet në diskrecionin e këtyre institucioneve, në varësi të rezultateve të hetimeve, nëse do të merren si provë. Kjo vlerësohet rast pas rasti, në varësi të rrethanave dhe nevojave të realizimit të procesit të rivlerësimit.

Shkaku i mësipërm i ngritur nga subjekti, nuk është i bazuar.

**59.2** Analiza financiare për këtë pasuri i përket periudhës 1992-2003, e cila siç është parashtruar edhe në pasurinë nr. 1, rezulton me diferencë negative në shumën -1.339.709 lekë, ndaj dhe të ardhurat rezultojnë të jenë të pamjaftueshme për të krijuar këtë pasuri.

Trupi gjykues, bazuar në sa më sipër, lidhur me pasurinë e trajtuar si pasuria nr. 2, apartament banimi, me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në {\*\*\*}, Tiranë, fituar me kontratën e shitblerjes me nr. {\*\*\*}rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 03.07.2003, regjistruar në ZRPP Tiranë më datë 07.07.2003, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare për të blerë këtë pasuri dhe është përpjekur ta paraqesë në mënyrë të pasaktë atë. Në këto rrethana faktike, në përputhje me parashikimet e nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, në lidhje me nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, parashikohet të prezumohet në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Rrjedhimisht, me të drejtë Komisioni, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, pasi rezulton se ka bërë deklarin të pamjaftueshëm për pasurinë.

### ***Shkaqet ankimore në lidhje me pasurinë nr. 3 dhe analizimi i tyre***

Ky shkak ankimor lidhet me pasurinë garazh, me sipërfaqe 23,4 m<sup>2</sup>, të ndodhur në rrugën {\*\*\*}, Tiranë.

Nga hetimi administrativ i kryer në Komision, rezulton se kjo pronë është deklaruar vetëm në deklaratën *vetting*, pasuri e blerë nga bashkëshortja e subjektit, me kontratën nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 18.01.2007, me çmimin 400.000 lekë, regjistruar në ZRPP Tiranë, më datë 12.02.2007 (certifikata pa numër).

Konkluzionet e Komisionit lidhur me këtë pasuri:

*Kjo pasuri nuk është deklaruar as në deklaratimet e vitit 2007 dhe as në deklaratimet e mëvonshme periodike, por vetëm në deklaratën vetting.*

*Subjekti i rivlerësimit e ka pranuar atë dhe është shprehur se ka qenë një harresë.*

*Mungesa e deklaratimit nga subjekti përbën veprime dhe qëndrime të subjektit të rivlerësimit në mosrespektim të ligjit nr. 9049, si dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 që, për rrjedhojë, çojnë në aplikimin e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*

60. Subjekti pretendon se mosdeklarimi i garazhit në deklaratën periodike të vitit 2007, është vetëm një harresë dhe gabim material i kryer pa dashje, por kurrsesi fshehje. Ky gabim është korrigjuar në deklaratën *vetting*, e cila duhej të ishte objekt i kontrollit nga Komisioni.

60.1 Lidhur me shkakun e mësipërm, trupi gjykues arsyeton se subjekti edhe pse e ka pranuar që nuk e ka deklaruar garazhin, pasi ka qenë një harresë nga ana e tij, ai kishte detyrimin ta deklaronte në deklaratën periodike të radhës, sipas ligjit nr. 9049, për ta përsëritur këtë deklaram në deklaratën *vetting*, sipas ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit e trajton si gabim material, i kryer pa dashje. Trupi gjykues çmon se koncepti i gabimit material do të ishte me vend të zbatohet nëse do të ishte fjala për gabime në shkrim ose llogari (neni 312 Kodi i Procedurës Civile). Në rastin konkret, trupi gjykues vëren se ndodhet përpara mungesës së deklaratimit të një prone ndër vite. Mungesa e deklaratimit ndër vite nuk mund të trajtohet si gabim material. Subjekti nuk e ka deklaruar këtë pronë dhe kjo sjellje e tij nuk mund të konsiderohet harresë, por mënyrë veprimi, për sa kohë që një problematikë e tillë haset edhe në garazhin tjetër, që ai nuk e ka deklaruar në vitin 2003.

Në këtë kontekst, trupi gjykues konsideron se gjendemi përpara situatës në të cilën ai është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë, dhe jo vetëm në një vit deklarimi, por në vazhdimësi, duke gjetur të zbatueshëm në këtë rast edhe nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të të cilit kjo rrethanë mund të konsiderohet si tregues i cenimit të besimit të publikut te drejtësia.

Bazuar në dispozitat e Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues thekson se subjektet e rivlerësimit në funksion të këtij procesi, në deklaratën *vetting* duhet të deklarojnë të gjitha pasuritë e akumuluar deri në atë moment, në mënyrë që të bëhet verifikimi i vërtetësisë dhe i saktësisë së plotësimit, duke i krahasuar me deklaratimet e tjera që nga deklarata para fillimit të detyrës e duke vazhduar me deklaratimet periodike. Është pikërisht përputhshmëria e këtyre deklaratimeve, që përbën vërtetësinë dhe saktësinë e kërkuar nga ligji, në përmbushje të qëllimit të tij. ILDKPKI-ja dorëzon në Komision raportin përfundimtar pas analizës së kryer, bashkë me dokumentacionin bashkëlidhur, si dhe dosjen e plotë me të gjitha deklaratat e subjekteve të rivlerësimit, të cilat mund të merren si provë nga Komisioni dhe Kolegji sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**60.2** Duke iu referuar rezultateve të relacionit financiar për këtë pasuri, rezulton se në këtë periudhë, subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet, për pasuritë e blera dhe kursimet e realizuara në vitin 2007.

Sa më sipër shkak i ngritur nga subjekti, lidhur me fshehjen e pasurisë, është i bazuar, ndërsa sa i përket cilësimit të këtij veprimi si harresë dhe gabim material, nuk është i bazuar.

Nga analiza ligjore dhe financiare e shkaqeve ankimore, e kryer në Kolegj, lidhur me pasurinë nr. 3, garazh me sipërfaqe 23,4 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën {\*\*\*}, Tiranë, pasuri e blerë nga bashkëshortja e subjektit, me kontratën nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 18.01.2007, regjistruar në ZRPP, Tiranë, me numër pasurie {\*\*\*}, më datë 12.02.2007, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, si pasojë e mosdeklarimit të këtij garazhi në deklaratën periodike. Situatë faktike kjo që, në përputhje me nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, parashikohet të prezumohet në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Rrjedhimisht, me të drejtë Komisioni, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, pasi rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë.

#### ***Shkaqet ankimore në lidhje me likuiditetet dhe analizimi i tyre***

- 61.** Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka kryer analizën financiare, nga e cila, në disa vite, bilanci rezulton negativ. Përkatësisht, në periudhën 1992-2003, si dhe në vitet 2004, 2005, 2008 dhe 2009, subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e kryera, njëkohësisht për të mundësuar kursimet e deklaruara në deklaratat periodike.

Konkluzionet e Komisionit lidhur me analizën financiare:

*Mungesë burimesh financiare të ligjshme, në periudhën 1992-2003, si dhe në vitet 2004, 2005, 2008 dhe 2009, që të mund të mjaftonin për të përballuar të gjitha shpenzimet e kryera nga familja e subjektit të rivlerësimit në periudhat respektive, si dhe për të realizuar kursimet e deklaruara. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se në prezencën e provave të deklarimeve të pamjaftueshme dhe të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera, gjen zbatim neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*

**61.1** Sa i përket analizës financiare të kryer nga Komisioni, referuar shkaqeve të ankimit, rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet, pasuritë e blera dhe kursimet në vitin 2004, pasi rezulton një diferencë negative prej -469.964 lekësh. Sa u përket llogaritjeve për vitin 2005, në analizën financiare rezulton një diferencë negative prej -1.331.632,4 lekësh. Lidhur me situatën financiare në vitin 2008, rezulton edhe këtu një diferencë negative në shumën -696.475,01 lekë. Gjithashtu edhe në vitin 2009, përsëri sipas analizës financiare, subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme në shumën -3.269.401,84 lekë.

**61.2** Trupi gjykues, në shqyrtim të shkaqeve të ankimit, në lidhje me situatën financiare, arriti në konkluzionin se ato nuk qëndrojnë për sa u përket rezultateve të arritura nga analiza financiare e Komisionit. Për pasojë, subjekti gjendet në pamjaftueshmëri financiare për të mbuluar shpenzimet e kryera prej tij, me burime të ligjshme për periudhën objekt shqyrtimi.

**61.3** Nga analiza ligjore dhe financiare e shkaqeve ankimore të pasurisë nr. 4, në lidhje me likuiditetet e subjektit, për periudhën kohore 1992-2003, rezulton një diferencë negative prej -1.339.708,69 lekësh, e cila është e ndryshme nga ajo që ka përlllogaritur

Komisioni (-1.972.969 lekë). Në konkluzion, edhe në Kolegj, bazuar në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, kursimet dhe shpenzimet e krijuara në këto vite. Si rrjedhojë, kjo situatë çon në aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për arsye se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë.

61.4 Nga analiza ligjore dhe financiare e shkaqeve ankimore, lidhur me pasurinë nr. 4 që u përket likuiditeteve për periudhat kohore në vitet 1992-2003, 2004, 2005, 2008 dhe 2009, situata financiare e subjektit rezulton minimalisht në nivelin e mungesës së burimeve të ligjshme, të konstatuara dhe të pranuar nga Komisioni. Shkaqet ankimore të ngritura nga subjekti nuk e cenojnë këtë rezultat në vlerësimin e trupit gjykues.

Në konkluzion, edhe në Kolegj, bazuar në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, kursimet dhe shpenzimet e krijuara në këto vite. Si rrjedhojë, kjo situatë financiare çon në aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për arsye se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë.

#### **Shkaqet ankimore lidhur me kriterin e kontrollit të figurës dhe analizimi i tyre**

62. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të pasaktë dhe të pavërtetë. Nga analiza e të dhënave të parashikuara në pikën 1, neni 38 i ligjit nr. 84/2016, dhe kryesisht bazuar në raportin e DSIK-së, rezultoi që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe mund të vihet nën presion nga këta persona. Si rrjedhojë, është konkluduar se subjekti është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës, ndaj duhet aplikuar neni Dh i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve të tij dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e kontakteve të mundshme të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016 (neni 34).

Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017, në lidhje me subjektin e rivlerësimit dhe në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

Sipas këtij raporti, rezulton se:

1. Subjekti i rivlerësimit Admir Thanza ka plotësuar saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, të firmosur më datë 25.01.2017.
2. Subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralite si ato që janë deklaruar në deklaratën e sipërpërmendur.
3. Subjekti nuk ka deklaruar me vërtetësi, pasi nuk ka deklaruar procedimin penal në ngarkim të tij, për veprën penale të parashikuar nga nenet 244 dhe 259 të Kodit Penal. Kjo çështje rezulton të jetë pushuar më datë 29 korrik 2016.
4. Ekzistojnë të dhëna se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme.
5. Ka gjithashtu pasaktësi në plotësimin e deklaratës për kontrollin e figurës, pasi subjekti nuk ka deklaruar kontaktet e papërshtatshme që ka pasur me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Ky mosdeklaram e ngarkon subjektin me përgjegjësinë e fshehjes së një fakti dhe të plotësimit të pasaktë dhe jo të vërtetë të deklaratës për kontrollin e figurës.

Si konkluzion, DSIK-ja ka konstatuar papërshtatshmërinë e z. Admir Thanza për vazhdimin e detyrës.

**62.1** Lidhur me mosdeklarimin e faktit të pushimit të procedimit penal nr. 3 të vitit 2016, subjekti pretendon se nuk e ka deklaruar për arsye se faktet që janë provuar nga hetimi, nuk përmbushin elemente të veprës penale, të parashikuara nga nenet 244 dhe 259 të Kodit Penal dhe as të ndonjë veprë tjetër penale, bazuar në nenin 328, pika 1, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale. Organi i Prokurorisë ka pushuar hetimin e procedimit penal, pasi ka konstatuar se nuk ka përfshirje të tijen dhe as të shtetases L.H. në asnjë veprë penale.

**62.2** Trupi gjykues ka konstatuar se ndaj subjektit të rivlerësimit, si dhe ndaj shtetases L.H., është filluar procedimi penal me nr. 3, datë 08.04.2016, regjistruar në Prokurorinë e Përgjithshme për veprat penale “Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuar përkatësisht nga nenet 244 dhe 259 të Kodit Penal. Më datë 29.07.2016, bazuar në nenin 328, pika 1, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale, Prokuroria e Përgjithshme vendos pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. 3 të vitit 2016. Këtë procedim penal subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën për kontrollin e figurës, të dorëzuar pranë DSIK, më datë 25.01.2017, me arsyetimin sipas shkakut të mësipërm, se nuk ka përfshirje në veprë penale.

Bazuar në nenin Dh, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit plotësojnë një deklaratë të detajuar për figurën e tyre, që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklarimit, sipas ligjit. Deklarata mund të përdoret si provë vetëm në këtë proces dhe në asnjë rast gjatë një procesi penal. Nga interpretimi i kësaj dispozite kushtetuese, rrjedh detyrimi i subjektit të rivlerësimit që të tregojë fakte të detajuara në lidhje me figurën e tij, fakte të cilat nuk do të përdoren si provë në asnjë rast, gjatë një procedimi penal. Legjislatori me anë të këtij formulimi ka pasur për qëllim të testojë integritetin moral, qëndrimin e subjektit të rivlerësimit në raport me vërtetësinë e fakteve, ngjarjeve të jetës së tij për një periudhë të caktuar. Mosdeklarimi nga ana e subjektit i procedimit penal nr. 3, pavarësisht se kemi të bëjmë me një procedim penal të pushuar sipas nenit 328, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale, për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale, e ngarkon subjektin me përgjegjësinë e fshehjes së një fakti dhe të plotësimit të pasaktë dhe të pavërtetë të deklaratës për kontrollin e figurës.

Objekt i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Pika 15 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, përkufizon që në kuptim të ligjit konsiderohet si person që është përfshirë në krimin e organizuar si vijon: “[...] Person i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person i cili është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm, me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur:

- a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet;
- b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet [...]”.

Pra, pika 15 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, është një dispozitë mjaft shtrënguese, që në personat e përfshirë në krimin e organizuar filtron edhe individët për të cilët procedimi penal ka filluar dhe është pushuar për shkak të vdekjes ose rastet kur personi nuk mund

të merret si i pandehur, si dhe personat të cilët janë deklaruar të pafajshëm për shkak se vepra penale është kryer nga një person që nuk mund të akuzohet ose dënohet, duke përjashtuar rastin e vetëm të përfshirjes në krimin e organizuar, kur personi është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në rastin konkret, për subjektin e rivlerësimit është vendosur pushimi i procedimit penal, në ngarkim të tij. Në këto rrethana, duke qenë se pushimi i procedimit penal nuk parashikohet si rast përjashtimor nga neni 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, si pasojë duhej të deklarohet nga subjekti i rivlerësimit dhe arsyetimi i subjektit nuk qëndron.

Sa më sipër, shkakun ankimor i ngritur nga subjekti, nuk gjendet i bazuar.

63. Subjekti pretendon se në ligjin e kohës (Kodi i Procedurës Penale), në nenin 75/a, veprat penale të parashikuara nga nenet 244 dhe 259 të Kodit Penal, për të cilat është filluar procedimi penal, nuk përfshiheshin. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 35/2017, këto dy vepra penale janë shtuar në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Duke qenë se ligji nr. 84/2016 ka hyrë në fuqi më datë 08.10.2016 dhe procedimi penal është pushuar më 29.07.2016, është evidente që këto vepra nuk parashikohen nga ligji i kohës, neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, duke shkelur kështu parimin e përgjithshëm se ligji material nuk ka fuqi prapavepruese.

63.1 Veprat penale për të cilat ka qenë proceduar shtetasja L.H., bashkë me subjektin e rivlerësimit, saktësisht nenet 244 dhe 259 të Kodit Penal, janë përfshirë në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 35/2017), i cili është botuar në Fletoren Zyrtare më datë 05.05.2017. Në pamje të parë, duket sikur subjekti i rivlerësimit nuk kishte detyrimin ta deklaronte në deklaratën e kontrollit të figurës. Nga ana tjetër, duke iu referuar pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ku bëhet përkufizim i individëve të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të këtij ligji, sipas të cilit është i përfshirë në krimin e organizuar çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht për veprat e parashikuara në nenin 3, pika 1 e ligjit nr. 10192 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, vërehet se njëra nga veprat (neni 244 i Kodit Penal), për të cilat janë proceduar shtetasja L.H. dhe subjekti i rivlerësimit është shtuar me ndryshimet e datës 20.03.2014, me ligjin nr. 24/2014. Ndërsa vepra tjetër e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, është përfshirë në këtë ligj me ndryshimet e datës 27.04.2017, me ligjin nr. 70/2017.

Si rrjedhojë, nëse i referohemi përkufizimit të “krimit të organizuar”, sipas pikës 8 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, veprat për të cilat është proceduar penalisht subjekti, nuk ishin të përfshira në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Referuar këtij përkufizimi dhe këtij momenti kohor, rezulton se subjektit në momentin e dorëzimit të deklaratës, konkretisht, më datë 25.01.2017, ligji nuk i ngarkon detyrimin për ta deklaruar në deklaratën e kontrollit të figurës atë procedim penal. Nga ana tjetër, duke iu referuar pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, vetëm njëra nga veprat për të cilat janë proceduar subjekti dhe shtetasja L.H. (neni 244 i Kodit Penal: “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”) ishte e përfshirë në ligjin nr. 10192. Për rrjedhojë të këtyre dispozitave, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ta deklaronte procedimin penal në deklaratën e kontrollit të figurës, në raport me kontaktin e papërshtatshëm, për efekt të saktësisë dhe vërtetësisë së plotësisimit.

63.2 Në nenin Dh, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, parashikohet se nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën. Nëse subjekti do ta deklaronte procedimin penal ndaj shtetasës L.H.

dhe ndaj tij, për saktësi dhe vërtetësi të plotësisimit të deklaratës së kontrollit të figurës, ligji parashikon edhe rrethana lehtësuese në bazë të nenit 38, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi të ishte parashtruar në mënyrë të besueshme nga subjekti i rivlerësimit.

Duke u nisur nga analiza e mësipërme trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti, me deklaratimet që ka bërë më datë 25.01.2017, në deklaratën e kontrollit të figurës, ka qenë në kushtet e pasaktësisë dhe pavërtetësisë së deklaratimit, siç me të drejtë ka konkluduar Komisioni. Në momentin e deklaratimit (25.01.2017), njëra vepër për të cilën ishin proceduar (korrupsioni aktiv), ishte e përfshirë në nenin 3, pika 1 e ligjit nr. 10192, aq sa për ta kategorizuar personin e kontaktit të papërshtatshëm si të përfshirë në krimin e organizuar për qëllim të ligjit nr. 84/2016.

Sa më sipër, shkak i ngritur nga subjekti, nuk është i bazuar.

64. Subjekti, nëpërmjet këtij shkak ankimor, pretendon se neni 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, në pjesën e parë të tij ka dhënë një kuptim të përgjithshëm, lidhur me personin e përfshirë në krimin e organizuar, kur ai rezulton i dënuar ose i proceduar penalisht, duke përjashtuar rastin kur personi “është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë”. Ndërsa në pjesën e dytë, germa “a” dhe “b” japin një parashikim më të specifikuar të përfshirjes së personit në krimin e organizuar. Germa “a” përkon me germën “ç”, pika 1 e nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, kurse germa “b” përkon me germën “ç”, pika 1 e nenit 388 të Kodit të Procedurës Penale. Ndaj subjekti pretendon se për të gjitha rastet e tjera të pushimit të procedimit penal, të përmendura në nenin 328 të Kodit të Procedurës Penale, personi nuk do të konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar.

64.1 Megjithëse subjekti mundohet të bëjë një krahasim të rasteve kur pushohet akuza ose çështja penale (neni 328 i Kodit të Procedurës Penale), me rastet kur gjykata merr vendim pafajësie (neni 388 i Kodit të Procedurës Penale) për të gjetur pikat e përbashkëta, me qëllim identifikimin e dispozitës për të cilën i është pushuar procedimi penal me shtetasen L.H. dhe barazimin e saj me dispozitat e rasteve kur jepet vendim pafajësie, trupi gjykues vëren se në ligjin nr. 84/2016 është parashikuar ngushtësisht rasti i cili e përjashton personin nga përfshirja në krimin e organizuar (shih arsyetimin e shtjelluar në paragrafin 62.2 më sipër).

Sa më sipër, shkak i ngritur nga subjekti, nuk gjendet i bazuar.

65. Subjekti ngre si shkak ankimor se neni 38, pika 4, germa “d” e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “Subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, publikuar ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës”. Sipas vendimit të pushimit të procedimit penal, subjekti është takuar me shtetasen L.H., më 31.01.2016 dhe 04.02.2016, ndërsa çështja penale ndaj saj është regjistruar më datë 08.04.2016. Si rrjedhojë, pretendon subjekti, në momentin e takimit të tij me personin në fjalë, kjo e fundit nuk ka qenë proceduar penalisht e, për pasojë, takimi i tij me të në këtë periudhë nuk kategorizohet si kontakt i papërshtatshëm.

65.1 Nga aktet në dosje, rezulton se ndaj shtetasen L. H., si dhe ndaj subjektit të rivlerësimit është filluar procedimi penal për veprën penale të korrupsionit aktiv të personit që ushtron funksione publike dhe korrupsioni pasiv (parashikuar nga nenet 244 dhe 259 të Kodit Penal) dhe ky procedim penal ndaj tyre është pushuar më datë 29.07.2016. Nuk rezulton të jetë marrë një vendim gjyqësor pafajësie i formës së prerë. Për pasojë, L.H. konsiderohet nga ligji si person i përfshirë në krimin e organizuar për efekt të këtij procesi dhe subjekti kishte detyrimin ta deklaronte këtë fakt në deklaratën për kontrollin e figurës në pjesën 5 të saj, te rubrika e të dhënave për sigurinë. Përveç shtetasen së sipërpërmendur, në këtë procedim penal është proceduar edhe subjekti i rivlerësimit. Për këtë arsye, në

rrethanat konkrete, problemi i kontaktit të papërshtatshëm nuk i referohet një personi të tretë, por ka të bëjë me vetë subjektin e proceduar penalisht dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se subjekti kishte detyrimin t'i deklaronte këto fakte me saktësi dhe mjaftueshmëri.

66. Subjekti pretendon se në pikën 8 dhe në pikën 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë parashikime të ndryshme lidhur me krimin e organizuar. Në pikën 8 jepet kuptimi i lidhjes së personit me veprën penale, kurse në pikën 15 përcaktohet lidhja e pasurisë me veprën penale. Kështu ndaj shtetasës L.H. nuk është marrë ndonjë masë pasurore sipas ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, ndaj ky fakt provon se shtetasja nuk ka qenë asnjëherë subjekt i këtij ligji, pra nuk mund të konsiderohet si person i përfshirë në krimin e organizuar.

66.1 Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, konstatohet se pika 8 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 jep një përkufizim të konceptit “Krim i organizuar, trafikim dhe korrupsion”, duke referuar se cilat janë veprat penale që klasifikohen si të tilla, ndërsa pika 15 e së njëjtës dispozitë jep përkufizimin e individëve të cilët, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, do të konsiderohen si persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Pra, pika 15 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 përcakton rrethin e personave të cilët në kuadër të procesit të rivlerësimit do të konsiderohen si persona të përfshirë në krimin e organizuar, duke referuar si të tillë persona që janë proceduar për veprat sipas pikës 1, neni 3 i ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 10192/2009).

Sipas parashikimit të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, konstatohet se, që një person të konsiderohet “i përfshirë në krimin e organizuar”, në kuptim të këtij ligji:

a) Duhet të jetë i proceduar penalisht për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr.10192/2009. Në kuptim të dispozitave procedurale penale, statusin e personit të proceduar penalisht e merr ai shtetas të cilit i regjistrohet emri në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, në zbatim të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, ku prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet, duke shënuar edhe emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale;

b) Personi i cili është proceduar për veprën si më lart, nuk duhet të jetë deklaruar i pafajshëm me një vendim gjyqësor të formës së prerë.

66.2 Në analizë të rrethanave të faktit, rezulton se shtetasja L. H. dhe subjekti i rivlerësimit janë proceduar penalisht për veprën penale të parashikuar nga nenet 244 dhe 259 i Kodit Penal dhe ndaj tij nuk është marrë një vendim gjyqësor pafajësie i formës së prerë. Për pasojë, ai konsiderohet nga ligji si person i kontaktit të papërshtatshëm, i përfshirë në krimin e organizuar për efekt të këtij procesi dhe subjekti kishte detyrimin ta deklaronte këtë fakt në deklaratën për kontrollin e figurës, tashmë në momentin e rivlerësimit, ku edhe veprat për të cilat janë proceduar, janë përfshirë në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në nenin 3, pika 1 e ligjit nr. 10192, si subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe shtetasja L.H., për efekt të ligjit nr. 84/2016 do të konsiderohen si persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se shkak i ngritur nga subjekti, nuk gjendet i bazuar.

66.3 Subjekti pretendon se duke iu referuar edhe vendimit të Gjykatës së Lartë nr. 126, datë 22.06.2016, paragrafi 23: *vendimi i pushimit të prokurorisë duhet të barazohet me vendim pafajësie të formës së prerë, për shkak se ai nuk rezulton të jetë ankimuar [...]”,* vendimi i pushimit barazohet me vendimin e pafajësisë së formës së prerë. Si rrjedhojë, duke analizuar vendimin nr. 3 të vitit 2016 të Prokurorisë së Përgjithshme, që është



vendim i formës së prerë, ky i fundit barazohet me vendimin e pafajësisë së formës së prerë.

**66.4** Në lidhje me pretendimin e mësipërm, trupi gjykues, duke pasur parasysh që fajësia dhe pafajësia jepen nga gjykata dhe, si pasojë, e një procesi gjyqësor në të cilin është bërë një vlerësim tërësor i fakteve e rrethanave të çështjes, çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron. Në procesin e dhënies së pafajësisë, gjykata shqyrton të gjitha elementet e një procesi themeli, në të cilin është konkluduar përfundimisht se personi nuk ka përgjegjësi penale për veprën për të cilën është proceduar. Ky është i vetmi kusht që personi i proceduar të mos bëjë pjesë në grupimin e personave të përfshirë në krimin e organizuar. Pra, që një person të jetë proceduar penalisht për veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192 dhe të mos quhet i përfshirë në krimin e organizuar, duhet domosdoshmërisht të jetë dhënë për të një vendim pafajësie i formës së prerë.

- 67.** Subjekti i rivlerësimit ankimon pikën 2 të raportit të DSIK-së, sipas së cilës: *Për subjektin e rivlerësimit A.TH. administrohen informacione nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e tij apo për kontakte të papërshtatshme.*

Subjekti pretendon se, nëse do të kishte prova të tjera veç atyre të procedimit penal nr. 3, këto prova duhet t'i viheshin në dispozicion nga Komisioni, i cili kishte detyrimin kushtetues e ligjor t'ia vinte në dispozicion dhe t'i jepte mundësinë për t'i kundërshtuar dhe të drejtën e mbrojtjes. Sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, *askush nuk mund të gjykohej dhe dënohej mbi bazën e provave për të cilat individit nuk ka mundësi të mbrohet.*

**67.1.** Në lidhje me këtë shkak ankimi, i cili është përmendur në raportin e DSIK-së, por nuk duket të jetë pasqyruar shprehimisht në vendimin e Komisionit, trupi gjykues vëren që në rastin konkret, përfundimi është një konstatim i grupit të punës, i ngritur në përmbushje të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i mbështetur në informacionet e agjencive ligjzbatuese (Prokurori e Përgjithshme, ShISH, ShÇBA). Po ashtu, e njëjta dispozitë e ligjit lejon mundësinë që informacioni të mos publikohet në rast se “[...] ai rrezikon sigurinë e burimit, ose për shkak të një kushti të përcaktuar nga qeveria e një shteti tjetër” (neni 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016). Bazuar në nenin A, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, subjektit të rivlerësimit i kufizohen pjesërisht të drejtat gjatë procesit të rivlerësimit. Në analizë të këtyre fakteve, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se vendimi i Komisionit është në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjin nr. 84/2016.

Sa më sipër, shkakun ankimor në lidhje me vlerësimin e figurës i ngritur nga subjekti, nuk gjendet i bazuar.

Nga analiza ligjore e shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin për kontrollin e figurës, subjekti rezulton me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, sepse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar dhe sepse ka bërë deklaram të pasaktë në lidhje me figurën, çka bën të pamundur vazhdimin e detyrës. Situatë faktike kjo, që në përputhje me parashikimet e nenit Dh, pikat 3 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës, parashikohet të prezumohet në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, problemet serioze gjatë kontrollit të figurës dhe deklarimi i pasaktë çojnë në aplikimin e nenit 61, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit.

### **Shkaqet ankimore lidhur me kriterin profesional, aftësitë organizative dhe analizimi i tyre**

Konkluzionet e Komisionit, lidhur me kriterin profesional, rezultuan se, pavarësisht vlerësimit pozitiv të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, subjekti i rivlerësimit, në saje të problemeve me etikën, të mosdorëheqjes së tij nga gjykimi i çështjes ku njëra nga palët ishte formalisht dhuruese ndaj tij, të konstatimit të papërshtatshmërisë së tij me

detyrën e gjyqtarit, të deklarimeve të pavërteta, të pamjaftueshme dhe fiktive, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë.

Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka përcjellë në Komision një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. {\*\*\*} prot., më datë 17.11.2017.

Raporti i përpiluar nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si më sipër, mbi “Aftësitë profesionale”, në paragrafin e raportit, kushtuar “Aftësive organizative”, shprehet që: *Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit, z. Admir Thanza, ka pasur mangësi në aftësinë për të administruar dosjet, pasi ka pasur mungesë të relacionit të relatorit, relacionet e këshilltarëve janë gjetur pa datë dhe pa firmë, dosjet kanë qenë pa listën e shpalljes së seancave dhe nuk ka pasur akt delegimi me detyrat e ngarkuara.*

*Në 3 prej 5 dosjeve mungonte procesverbali për seancën në dhomë këshillimi, në mosrespektim të nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile (dosjet nr. 3, nr. 4, nr. 5).*

Pra, rezultoi se Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë kishte konstatuar mangësi në aftësinë e administrimit të dosjeve, por, gjithsesi, duke qenë pozitive të gjitha vlerësimet e tjera profesionale të kryera prej tij, ai ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit është i aftë për vazhdimin e detyrës së tij.

68. Subjekti pretendon në lidhje me aftësitë organizative se konstatimi i vetëm i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është i pambështetur në ligj. Lidhur me konstatimet për problemet që lidhen me relacionet e këshilltarëve, sipas nenit 20 të ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohej se gjyqtari ka deri në dy ndihmës ligjorë, si dhe parashikohej në nenin 21 të po këtij ligji se ndihmësit ligjorë studiojnë ankimet, dosjet gjyqësore, përgatisin relacionet për çështjet që janë në gjykim duke dhënë mendimin e tyre, u përgjigjen ankesave, përgatisin materialet e nevojshme [...]”. Prandaj, sipas subjektit, është detyrë e ndihmësve ligjorë përgatitja e relacionit dhe plotësimi i tij me elementet e domosdoshme procedurale. Për këtë arsye, mangësi të kësaj natyre nuk lidhen me çështje të aftësive organizative të një gjyqtari të Gjykatës së Lartë.

68.1 Në përgjigje të shkakut të mësipërm, trupi gjykues vlerëson se relacionet përgatiten prej këshilltarëve dhe është detyrë e secilit që harton një dokument, ta plotësojë me ekstremitetet dhe elementet që e plotësojnë për vlefshmërinë e tij. Si rrjedhojë, edhe gjyqtari që e pranon në dosje një relacion të pafirmosur nga këshilltari, tregon një lloj indiferentizmi në administrimin e dosjes, aq më tepër që një gjyqtar i Gjykatës së Lartë ka deri në dy këshilltarë dhe, duke pranuar në dosje një relacion të pafirmosur dhe të padatuar, e bën të paidentifikueshëm autorin e relacionit. Një mënyrë e tillë pune, me mangësi, ndikon në vlerësimin e aftësive organizative të gjyqtarit, si rrjedhojë edhe në shqyrtimin e çështjes.

69. Subjekti pretendon edhe sa u përket mangësive të konstatuara me procesverbalet në dhomë këshillimi, në Gjykatën e Lartë në çështjet civile nga Kolegji Civil, nuk mbahet procesverbal.

69.1 Duke iu referuar shkakut të mësipërm, megjithëse rezultoi të jetë praktikë e Gjykatës së Lartë të mos mbajnë procesverbal në dhomë këshillimi, trupi gjykues vëren se në parim, procesverbali është akti procedural i cili dokumenton të gjitha veprimet e seancës apo dhomës së këshillimit. Megjithëse neni 118 i Kodit të Procedurës Civile jep detaje se çfarë duhet të tregojë një procesverbal në seancë, ky i fundit duhet të mbahet edhe në

dhomë këshillimi, për të detajuar veprimet procedurale të ndërmarra nga trupi gjykues (në rastin e Gjykatës së Lartë). Fakti që në dy dosje është gjetur procesverbali dhe në tre të tjera jo, do të thotë që ky veprim është anashkaluar dhe nuk ka kuptim arsyetimi që ka dhënë subjekti i rivlerësimit nëpërmjet shkakut të mësipërm, që për çështjet civile nuk merr pjesë sekretari gjyqësor, pasi nuk është në iniciativën e këtij të fundit pjesëmarrja në dhomë këshillimi dhe plotësimi i procesverbalit. Trupi gjykues vlerëson se shkakut i ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit, nuk është i bazuar.

### **Shkaqet ankimore lidhur me etikën dhe integritetin, si dhe analizimi i tyre**

70. Subjekti pretendon se kontrata e dhurimit është realizuar vetëm për formalizimin e regjistrimit në ZRPP Shkodër, ndaj nuk përbën një dhurim të mirëfilltë, aq më tepër që ky dhurim të ketë cenuar pavarësinë apo paanshmërinë gjatë një procesi gjyqësor.

70.1. Me kontratën e shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., lidhur më datë 06.04.2000, ndërmjet shitësit F.C dhe blerësve familja {\*\*\*}, parashikohet shitja e apartamentit 3 + 1 në Shkodër, rruga {\*\*\*}, me pjesët përbërëse të përshkruara në kontratë, si dhe një garazh me sipërfaqe 18 m<sup>2</sup>, i pozicionuar i pesti nga rruga kryesore. Kjo pronë është regjistruar pranë ZRPP Shkodër, më datë 26.02.2003, me përshkrimin apartament banimi me sipërfaqe 136 m<sup>2</sup>. Megjithëse ky apartament është blerë nga familja {\*\*\*} që në vitin 2000 dhe është regjistruar në vitin 2003, në certifikatën e regjistrimit nuk përmendet garazhi, por vetëm sipërfaqe totale 136 m<sup>2</sup>, që përbën vetëm sipërfaqen e apartamentit. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shkaqet e ankimit, në vlerësim të dokumenteve të administruara në fashikull vëren:

- o Kontrata e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 06.04.2000, që i ka kaluar titullin e pronësisë familjes {\*\*\*} edhe për pronën garazh, është e vlefshme, referuar kjo në dispozitat e Kodit Civil (neni 83).
- o Pronësia mbi një pasuri të paluajtshme kalon në çastin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit të kësaj pasurie. Blerësi ose përfituesi i kësaj pasurie bëhet pronar i ligjshëm i saj, që në momentin e nënshkrimit të kontratës, duke fituar dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me qenien e tij si pronar mbi këtë pasuri, ashtu sikurse nga ana tjetër, me nënshkrimin e kontratës, shitësi i humb të gjitha të drejtat mbi sendin.
- o Regjistrimi ose transkriptimi i një veprimi juridik nuk është një element i vlefshmërisë së tij (kontratës). Mosregjistrimi i kontratës në regjistrat e pasurive të paluajtshme nuk e bën kontratën e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme të pavlefshme, por nuk i jep mundësinë blerësit që ta tjetërsojë atë të tretët.
- o Subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij ishin pronarë të sendit garazh dhe nuk kishin pse të nënshkruanin një kontratë dhurimi (të simuluar) vetëm për regjistrim të saj në ZVRPP Shkodër.
- o Nga ana tjetër, shoqëria {\*\*\*}, me përfaqësues z. F.C, ishte zhveshur nga tagrat e pronarit të garazhit që në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 06.04.2000. Rregullimi i gabimit që rezultonte në ZVRPP Shkodër duhej bërë administrativisht, duke iu drejtuar kësaj zyre njëri prej përfaqësuesve të blerësve, të familjes {\*\*\*}, me kërkesë për regjistrimin e titullit të pronësisë mbi garazhin në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme në Shkodër.

70.2 Në kartelën e pasurisë, lëshuar nga ZRPP Shkodër, më datë 29.03.2017, pasuria “garazh” rezulton të jetë regjistruar më datë 17.04.2000 nga F.C, dhe për të është lëshuar certifikata e pronësisë më datë 07.08.2013. Pra, rezulton që prona “garazh” të jetë regjistruar në ZRPP pak ditë pasi është bërë shitja e apartamentit me sipërfaqe 136 m<sup>2</sup>, e

cila edhe pse është specifikuar në kontratë se është blerë nga blerësit {\*\*\*}, rezulton se është regjistruar në emër të ndërtuesit {\*\*\*}.

Më datë 22.04.2017, pranë një zyre noterie në Shkodër, palët: dhuruese shoqëria {\*\*\*} dhe pranuese e dhurimit familja {\*\*\*}, lidhin kontratën e dhurimit me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., dhe bëjnë regjistrimin e kësaj kontrate dhurimi në ZRPP Shkodër. Kontrata e dhurimit nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 22.04.2017, ngjan të jetë një veprim juridik i simuluar, pasi është bërë nga një dhurues që nuk kishte të drejtë ta dispononte sendin e dhuruar, pasi e kishte humbur më parë pronësinë e tij me kontratën e shitjes me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., lidhur më datë 06.04.2000.

71. Subjekti pretendon se nuk gjendet para konfliktit të mundshëm të interesit, për sa u përket çështjeve të shoqërisë ndërtimore {\*\*\*} SHPK në Gjykatën e Lartë. Konflikti i interesit nuk mund të ndodhte, sepse interesi i supozuar nuk ka ekzistuar as në momentin e lidhjes së kontratës së dhurimit, pasi çështja në Gjykatën e Lartë ku subjekti ka qenë relator, nuk lidhet fare me zgjidhjen e konfliktit të themelit ndërmjet palëve ndërgjyqëse, pasi ishte një konflikt ndërmjet gjykatave, lidhur me çështje të kompetencës lëndore.

71.1 Në pyetësin e parë, më datë 20.12.2017, të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur pyetjes lidhur me favorët dhe dhuratat, duke u shprehur se nuk ka marrë ndonjë dhuratë me vlerë mbi 500 euro në periudhën 2011-2017. Gjithashtu, në pyetësin e dytë, të nisur në datën 10.03.2018, subjekti është përgjigjur se nuk ka ndonjë rast që t'i kenë bërë dhurata apo favore persona për të cilët ka marrë vendime apo ka kontribuar në vendimmarrje. Në kontratën e mësipërme të dhurimit, të datës 22.04.2017, me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., rezulton që shoqëria {\*\*\*} SHPK i ka dhuruar subjektit të rivlerësimit garazhin me sipërfaqe 18 m<sup>2</sup>. Nga ana tjetër, rezulton se më datë 06.03.2018, subjekti ka dhënë vendim për një çështje nr. {\*\*\*}, në Gjykatën e Lartë, ku vetë subjekti ishte relator i çështjes në fjalë, ndërsa shoqëria {\*\*\*} ishte palë e interesuar.

Disponibiliteti dhe dakordësimi i shoqërisë së ndërtimit për të ndihmuar subjektin e rivlerësimit për të kryer një veprim juridik të simuluar (kontratë dhurimi, datë 22.04.2017), si dhe rasti tjetër që shoqëria "{\*\*\*} SHPK në vitin 2000 i ka shitur subjektit të rivlerësimit një apartament nën koston e ndërtimit për kohën kur është bërë, të çojnë në përfundimin e një marrëdhënieje të vazhdueshme të mirë mes palëve, e cila ka ndikuar në vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit.

Nga ana tjetër, lidhur me çështjen ku subjekti i rivlerësimit ka qenë relator i çështjes së cituar në paragrafin më sipër, është një çështje që nuk është çështje kompetence nga vetë informacioni i ardhur nga Gjykata e Lartë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 23.03.2018, por është çështje që është gjykuar themeli dhe subjekti i rivlerësimit ishte në konflikt interesi. Për pasojë, në përputhje me nenin 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ishte në konflikt interesi në gjykimin e çështjes nr. {\*\*\*}, në Gjykatën e Lartë. Për më tepër, siç ka vendosur Kolegji i Posaçëm i Apelit, lidhur me paanshmërinë, "gjyqtarët duhet të ushtrojnë funksionet e tyre me paanshmëri të plotë, si dhe të garantojnë aparençën e paanshmërisë" (qëndrim i mbajtur në vendimin nr. 9, datë 24.10.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit).

### **Shkaqet ankimore në lidhje me precedentin penal dhe analizimi i tyre**

Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit Admir Thanza, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë, sistem në të cilin ai ka shërbyer në nivele të larta, për shumë vite. Për rrjedhojë, duhet aplikuar pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

72. Subjekti pretendon se Komisioni mund të hetonte dhe të vlerësonte të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit bazuar në tri kriteret, por për asnjë arsye nuk duhej të bënte interpretimin për mënyrën e plotësimit në formularin e vetëdeklarimit. Vlerësimi i të dhënave të pasqyruara në këtë formular i referohet vetëm ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” (në vijim ligji nr. 138/2015).

72.1 Në analizë të shkakut të mësipërm, rezulton se subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. {\*\*\*} të datës 21.06.1999, të gjykatës të Pizës (Itali), është dënuar për veprën penale të vjedhjes në bashkëpunim, me 40 ditë burgim dhe një gjobë prej 100.000 liretash. Në pyetjen 8 të pyetësorit të datës 10.03.2018, dërguar nga Komisioni, pyetjes nëse ka qenë ndonjëherë i hetuar, i ndaluar, i shoqëruar, i arrestuar, i dënuar me vendim gjyqësor në Shqipëri apo në ndonjë shtet tjetër të huaj, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur duke referuar një hetim të kryer në Shqipëri për korrupsion, i cili është pushuar nga organi i akuzës në vitin 2016, por nuk ka referuar ekzistencën e dënimit të tij në Itali.

Subjekti gjithashtu në plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, të cilin e ka plotësuar më datë 25.04.2016, nuk ka referuar ndonjë rast që të ketë qenë i ndaluar, i hetuar, i gjykuar apo i dënuar me vendim jopërfundimtar të formës së prerë, nga autoritetet shqiptare apo të huaja. Gjatë hetimit, Komisioni ka administruar dokumente në lidhje me një gjetje të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, të bashkëlidhur me një shkresë përcjellëse të Ministrisë së Drejtësisë, me nr. {\*\*\*} prot., datë 20.04.2018, e cila referon dënimin e mësipërm.

72.2 Procesi i rivlerësimit përfshin kontrollin e tri kriterëve, të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të aftësive profesionale, i cili konsiston në kontrollin e deklaratave përkatësisht sipas kriterit të rivlerësimit, të përcaktuara në shtojcat e ligjit nr. 84/2016. Në deklaratën e kontrollit të figurës, nuk parashikohen pyetje që kanë lidhje me vetë subjektin e rivlerësimit në lidhje me ndalime, hetime, gjykime apo dënime. Gjithashtu, periudha e vlerësimit të aftësive profesionale është 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës, por vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 01.01.2006 e në vazhdim. Këto informacione merren parasysh nga Komisioni dhe Kolegji nëse çmohen si të domosdoshme nga relatori dhe vëzhguesit ndërkombëtarë për procesin e rivlerësimit.

Në vlerësimin e trupit gjykues, edhe pse formulari i vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015, nuk është objekt kontrolli në procesin e rivlerësimit, pyetjeve të pyetësorit të dërguar nga Komisioni, subjekti duhet t’u përgjigjej me korrektesë dhe saktësi. Bazuar në nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit bashkëpunon me Komisionin dhe Kolegjin, të cilët në marrjen e vendimit, mbajnë parasysh gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit. Në kuadër të vlerësimit tërësor të procedurave për garantimin e integritetit, si dhe bashkëpunimit me organet e rivlerësimit, subjekti duhej të deklaronte dënimin penal të vitit 1999 në Itali. Bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në të cilën parashikohet se vendimi për subjektin merret edhe në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, për sa më sipër, me të drejtë Komisioni e ka mbështetur vendimin të kërkesat e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

Sa i përket shkakut ankimor të mësipërm, trupi gjykues nuk e gjen të bazuar.

73. Subjekti pretendon se Komisioni ka bërë shkelje të rëndë, lidhur me publikimin e kësaj të dhëne personale sensitive, publikimi i së cilës në seancë dëgjimore ka shkaktuar mediatizimin e saj, duke e cenuar në mënyrë flagrante dhe duke shkelur kështu nenin 3, pika 2, si dhe nenet 5, 6, 7, 8 dhe 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 9887).

73.1 Lidhur me shkakun e mësipërm, Aneksi i Kushtetutës në nenin A të tij ka parashikuar kufizime të të drejtave kushtetuese dhe saktësisht në paragrafin e parë: *Me qëllim kryerjen*

*e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen më të drejtën për respektimin e jetës private, si dhe nenet 36 dhe 37, dispozitat që lidhen me barrën e provës, nenet 128, 131, nënparagrafi “f”, 135, 138, 140, 145, paragrafi 1, 147/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, 149/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës. Nga ana tjetër, neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve.*

Gjithashtu, duke iu referuar vetë ligjit nr. 9887, në nenin 4, pika 4, germa “b” e tij, parashikohet se ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publikë zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre. Pra, përpunimi i të dhënave personale dhe mbrojtja e tyre gjen kufizim nga Kushtetuta, Aneksi i Kushtetutës dhe në raste të caktuara edhe nga vetë ligji nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke i parashikuar si raste përjashtimore të mbrojtjes së të dhënave personale për subjektet e rivlerësimit.

Sa i përket shkakut të mësipërm të subjektit, nuk është i bazuar.

Sa më sipër, megjithëse formulari i vetëdeklarimit sipas ligjit 138/2015, nuk është objekt kontrolli në procesin e rivlerësimit, trupi gjykues çmon se subjekti nuk u është përgjigjur me vërtetësi pyetësorëve të Komisionit, duke mos u treguar bindës dhe i vërtetë edhe lidhur me informacionin e precedentit dhe dënimit penal ndaj tij në Itali.

Nga analiza ligjore e shkaqeve ankimore, lidhur me kriterin e kontrollit profesional, në raport me vendimin dhe aktet e administruara në këtë çështje nga Komisioni, trupit gjykues, nga vlerësimi tërësor i procedurave, i rezulton se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij ka cenuar besimin e publikut tek institucionet e sistemit të drejtësisë, duke i bërë kështu të aplikueshme kërkesat e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

### **Konkluzionet e trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

Trupi gjykues, pasi u njoh me të gjitha aktet e ardhura dhe të administruara nga Komisioni, e shqyrtoi vendimin nr. 40, datë 17.07.2018, mbi bazën e shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe të neneve 47, 48, 49, 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Nga analiza dhe shqyrtimi i shkaqeve të ankimit të subjektit, në raport me provat dhe aktet e shqyrtuara dhe të administruara nga Komisioni në këtë çështje, trupi gjykues arriti në konkluzionin se:

I. Lidhur me pasurinë e trajtuar si pasuria nr. 1, apartament banimi 3 + 1, me sipërfaqe 136 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën {\*\*\*}, Shkodër, fituar me kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 06.04.2000, regjistruar në ZRPP Shkodër me numër pasurie {\*\*\*}, më datë 18.05.2000, subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë e tij dhe nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë. Situata faktike kjo që në përputhje me parashikimet e nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, në lidhje me nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, parashikohet të prezumohet në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Rrjedhimisht, me të drejtë Komisioni bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit pasi rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë.

II. Lidhur me pasurinë e trajtuar si pasuria nr. 2, apartament banimi, me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në {\*\*\*}, Tiranë, fituar me kontratën e shitblerjes me nr. {\*\*\*}rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 03.07.2003, regjistruar në ZRPP Tiranë, më datë 07.07.2003, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare për të blerë këtë pasuri dhe është përpjekur ta paraqesë në mënyrë të pasaktë atë. Situatë faktike kjo që, në përputhje me parashikimet e nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, në lidhje me nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, parashikohet të prezumohet në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Rrjedhimisht, me të drejtë Komisioni, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, pasi rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë.

III. Nga analiza ligjore e shkaqeve ankimore lidhur me pasurinë nr. 3, garazh me sipërfaqe 23,4 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën {\*\*\*}, Tiranë, pasuri e blerë nga bashkëshortja e subjektit, me kontratën nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 18.01.2007, regjistruar në ZRPP Tiranë, me numër pasurie {\*\*\*}, më datë 12.02.2007, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm, si pasojë edhe mosdeklarimin e këtij garazhi në deklaratën periodike. Situatë faktike kjo që, në përputhje me nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, parashikohet të prezumohet në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Rrjedhimisht, me të drejtë Komisioni bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, pasi rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë.

IV. Nga analiza ligjore dhe financiare e shkaqeve ankimore lidhur me pasurinë nr. 4 që u përket likuiditeteve për periudhat kohore në vitet 1992-2003, 2004, 2005, 2008 dhe 2009, situata financiare e subjektit rezulton me diferenca negative të konsiderueshme. Bazuar në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, kursimet dhe shpenzimet e krijuara në këto vite. Si rrjedhojë, kjo situatë financiare çon në aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për arsye se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë.

V. Nga analiza ligjore e shkaqeve të ankimit, subjekti rezulton me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, sepse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar dhe sepse ka bërë deklaram të pasaktë në lidhje me figurën, çka bën të pamundur vazhdimin e detyrës. Situatë faktike kjo që, në përputhje me parashikimet e nenit Dh, pikat 3 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës parashikohet të prezumohet në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, problemet serioze gjatë kontrollit të figurës dhe deklarimi i pasaktë passjellin aplikimin e nenit 61, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, në të cilat parashikohet shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit.

VI. Nga analiza ligjore e shkaqeve ankimore, lidhur me kriterin e kontrollit profesional, në raport me vendimin dhe aktet e administruara në këtë çështje nga Komisioni, trupit gjykues, nga vlerësimi tërësor i procedurave, i rezulton se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut tek institucionet e sistemit të drejtësisë, duke i bërë kështu të aplikueshme kërkesat e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që parashikon shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

VII. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e mësipërme, në mbështetje të nenit D, pikat 3 dhe 5, nenit Dh, pikat 3 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 61, pikat 2, 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 40, datë 17.07.2018, është i drejtë, i bazuar në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet lënë në fuqi.

**PËR KËTO ARSYE:**

Trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016,

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 40, datë 17.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Admir Thanza.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
3. U shpall në Tiranë, sot, më datë 18.04.2019.

**ANËTAR**

**Luan DACI**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Ardian HAJDARI**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*